



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA

STRATEGJIA PËR SHKOLLAT PROMOVUESE TË SHËNDETIT NË KOSOVË 2009 - 2018

Tetor 2009, Prishtinë



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Arsimit, Shkencës
dhe Teknologjisë

Ministry of Education,
Science & Technology

Ministarstvo za Obrazovanje,
Nauku i Tehnologiju

Ministria e Shëndetësisë

Ministry of Health

Ministarstvo Zdravlja

Ministria e Mjedisit dhe
Planifikimit Hapësinor

Ministry of Environment
and Spatial Planning

Ministarstvo Sredine i
Prostornog Plariranja

Ministria e Kulturës,
Rinisë dhe Sportit

Ministry of Culture,
Youth and Sports

Ministarstvo Kulture,
Omladine i Sporta

Komiteti Ndërmintor për shkollat promovuese të shëndetit

STRATEGJIA PËR SHKOLLAT PROMOVUESE TË SHËNDETIT NË KOSOVË 2009 – 2018

Tetor 2009, Prishtinë

Fjala e Ministrave për strategjinë Shkollat Promovuese të Shëndetit

STRATEGJIA PËR SHKOLLAT PROMOVUESE TË SHËNDETIT NË KOSOVË paraqet kornizën themelore përmes së cilës, sektorët e arsimit, shëndetësisë, mjedisit, rinisë, individët, organizatat qeveritare e joqeveritare, sektori i biznesit dhe të gjithë të interesuarit, do të zbatojnë programe të veçanta, me qëllim të ngritjes së cilësisë së punës, si të mësimdhënies ashtu edhe të mësimnxënies, në një mjedis shkollor të shëndetshëm e të përshtatshëm, pa dhunë, diskriminim, dhe të hapur për ide të reja. Kjo do të mundësojë që bashkësia të realizojë synimet në ngritjen e cilësisë së jetës, me një bashkëpunim aktive në këtë proces.

Kjo strategji do të jetë pjesë integrale e prioritetëve dhe politikave zhvillimore qeveritare në fushën e arsimit, shëndetësisë, mjedisit, rinisë etj. E tillë është edhe strategjia për shkollimin parauniversitar, e cila ndërlihd shumë pjesë të kësaj strategjie, sidomos pjesën që i përket infrastrukturës, pa zgjidhjen e së cilës nuk do të mund të funksionojë dhe jetësohet në mënyrë adekuate as Strategjia e Shkollave Promovuese të Shëndetit.


Interaksioni i mjedisit shkollorë me rrethin do të jetë një epiqendër e veprimit të mëtejshëm, si qeveritar ashtu edhe joqeveritar, sepse shumë nga prioritetet e përcaktuara, nuk do të jetë e mundur të realizohen në periudhën e parapara për zbatimin e plotë të strategjisë, pa një bashkëpunim funksional.

Ky dokument është përgatitur me anë të konsultimeve të gjera me ekspertë të shumtë vendor të lëmenjve të ndryshëm, duke u bazuar edhe në përvojat e vendeve të Evropës, të cilat tashmë kanë arritur shumë rezultate pozitive në realizimin e koncepteve të ndryshme të shkollave promovuese të shëndetit.

Duke qenë të bindur që ky dokument do të ndihmojë Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, por edhe Ministrinë e tjera të inkuadruara në zbatimin e kësaj strategjie, i ftojme të gjitha institucionet qeveritare e joqeveritare si dhe komunitetin e biznesit që, me pjesëmarrjen aktive në realizimin e aktiviteteve të parapara, të bëhen bashkëpunim në ngritjen e cilësisë së jetës, cilësisë së mësimdhënies e të mësimnxënies, për krijimin e një shkolle dhe mjedisi shkollor bashkëkohor sipas të gjithë parametrave dhe standardeve të pranuar ndërkombëtare.


Ministri i MASHT

Enver Hoxhaj



Ministri i MSH

Alush Gashi



Ministri i MMPH

Mahir Jagxhilar



Ministri i MKRS

Valton Beqiri



**LISTA E PJESËMARRËSVE QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E
STRATEGJISË PËR SHKOLLAT PROMOVUESE TË SHËNDETIT**

**GRUPI PUNUES PËR HARTIMIN E STRATEGJISË SË
SHPSH**

Nezir Çoçaj, MASHT
Leonora Shala, MASHT
Fadile Dyla, MASHT
Miranda Kasneci, MASHT
Ramush Lekaj, MASHT
Pashkë Buzhala, MSH
Mirushe Emini, MKRS
Ismet Potera, MMPH
Bajram Kadriu, MMPH
Iilir Begolli, IKSHPK
Igballe Krasniqi, ZRA - Prizren
Muharrem Peci, ZRA - Mitrovicë
Ardita Tahirukaj, OBSH
Afërdita Spahiu, UNICEF
Ruhije Hoxha, IOM

PJESËMARRËSIT NË PUNËTORI PËR HARTIMIN E STRATEGJISË SË SHPSH

Enesa Kadiq, MASHT
Radica Berishaj, MASHT
Tone Buzhala-Gashi, MMPH
Besim Kamberaj, MAPL
Nurishahe Hulaj, IKSHPK Prizren
Drita Salihu, IKSHPK
Demë Mulliqi, ZRA - Pejë
Zef Osmani, ZRA - Gjakovë
Bedredin Koro, ZRA - Prizren
Mujë Prekupi, DKA - Lipjan
Alush Istogu, DKA - Drenas
Dukagjin Popovci, KEC
Nexhip Sheholli, MSh
Sami Uka, OBSH
Valerie Nizigama, UNMIK
Dren Rexha, UNICEF
Gordana Peroviq, UNICEF - Mitrovicë
Jasmina Antiq, Mitrovicë
Valentina Berisha, OJQ - DEA
Edmond Aliaga
Abdyl Taçi, drejtor - Mamushë
Engjëllushe Susuri, mësimdhënëse - Prizren
Hyre Salihu, mësimdhënëse - Podujevë
Shyhrete Reçica, drejtore - Lipjan
Luan Muja, nxënës - Prizren
Shpejtim Kajdomçaj, nxënës - Prizren

SHKURTESAT E PËRDORURA

BK	Buxheti i Kosovës
IPVQ	Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MRKSÇJ	Ministria e Rinisë, Kulturës, Sportit dhe Çështjeve jorezidente
MSH	Ministria e Shëndetësisë
DKA	Drejtorati Komunal për Arsim
ZRA	Zyra Regjionale e Arsimit
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
IOM	Organizata Ndërkombëtare e Migrimit

PËRMBAJTJA

FJALA E MINISTRAVE PËR STRATEGJINË SHPSH.....	i
GRUPI PUNUES.....	i
SHKURTESAT E PËRDORURA.....	iv
PËRMBAJTJA.....	v
PËRMBLEDHJA E STRATEGJISË.....	viii
1. HYRJE.....	1
1.1. Arsyetja për përpilimin e strategjisë së shkollave promovuese të shëndetit.....	1
1.2. Të dhënat demografike, sociale dhe ekonomike themelore për Kosovën dhe konteksti historik i zhvillimit të arsimit në Kosovë para vitit 1999.....	5
1.3. Situata aktuale në arsimin e Kosovës.....	8
1.3.1. Sistemi administrativ.....	9
1.3.2. Sistemi i shkollimit parauniversitar.....	9
1.3.3. Infrastruktura e shkollave në periudhën pas vitit 1999.....	10
1.4. Parimet dhe konceptet aktuale të shkollave Promovuese të shëndetit në botë dhe ato që sigurojnë një mjedis të shëndoshë.....	12
1.4.1. Koncepti dhe kriteret e shkollave promovuese të definuara sipas OBSH-së.....	13
1.4.2. Koncepti i shkollave "Mike për Fëmijët" i zhvilluar nga UNICEF-i.....	15
1.5. Shkollat promovuese në kontekstin e sotëm.....	16
1.5.1. Konteksti politiko-shoqëror.....	16
1.5.2. Parimet themelore të shkollave promovuese të shëndetit në kontekstin kosovar.....	17
1.5.3. Arritjet në fushën e shkollave promovuese të shëndetit në Kosovë pas vitit 1999.....	20
2. VIZIONI.....	25
3. MISIONI.....	25
4. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË.....	26

4.1.	Mjedis i shëndetshëm dhe përkrahës nga ana e mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve.....	26
4.1.1.	Fushata vetëdijesimi për mjedisin dhe shëndetin	27
4.1.2.	Hartimi i programeve dhe materialeve për shëndetin dhe mjedisin shkollor	28
4.1.3.	Trajnime të punonjësve të arsimit për qasjen e SHPSH	29
4.2.	Mjedis fizik i përshtatshëm dhe i shëndetshëm për mësimdhënie dhe të nxënë (mbështetur në udhëzimet e strategjisë për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë 2007-2018).....	30
4.2.1.	Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese shkollore	31
4.2.2.	Monitorimi i hapësirave të reja rekreative shkollore	32
4.2.3.	Sigurimi i mirëmbajtjes dhe ruajtja e pasurisë shkollore	32
4.2.4.	Pajisja e shkollave me mjete mësimore që sigurojnë ruajtjen e shëndetit	32
4.3.	Kapacitete të mjaftueshme njerëzore dhe materiale	33
4.3.1.	Aftësimi i personelit arsimor për promovim të shëndetit	34
4.4.	Përkujdesje cilësore dhe e vazhdueshme për shëndetin e nxënësve	36
4.4.1.	Ruajtja dhe përparimi i shëndetit të nxënësve.....	36
4.4.2.	Ruajtja dhe promovimi i shëndetit mendor të nxënësve.....	37
4.4.3.	Ruajtja dhe promovimi i shëndetit emocional të nxënësve.....	38
4.5.	Shkallë e ulët e dhunës në shkollë	39
4.5.1	Nxënësit, prindërit, mësimdhënësit dhe stafi tjetër shkollor janë të vetëdijshëm për dukurinë e keqtrajtimit.	39
4.5.2	Rrjeti mbrojtës është i krijuar dhe funksionon	39
4.5.3.	Janë të zhvilluara sistemet e referimit në mes të shkollës dhe shërbimeve të tjera në komunitet.....	40

4.5.4.	Viktimat e keqtrajtimit kontaktojnë rrjetin mbrojtës dhe kërkojnë ndihmë.	40
4.5.5.	Rrjeti u përgjigjet të dyja palëve, viktimës dhe autorit të veprës.	40
4.5.6.	Monitorimi dhe vlerësimi i masave të realizuara në lidhje me dhunën në shkolla.	40
4.6.	Niveli i kënaqshëm i kulturës shëndetësore dhe mjedisore të nxënësit.....	41
4.6.1.	Përgatitja e materialeve didaktike për promovim shëndetësor	41
4.6.2.	Organizimi i aktiviteteve për promovimin e shëndetit të nxënësve, punonjësve të arsimit, prindërve dhe bashkësisë	42
4.6.3.	Bashkëpunimi i shkollës me institucionet e tjera relevante për shërbime profesionale	43
4.6.4.	Formimi i grupeve për promovimin e shëndetit në shkollë	43
4.6.5.	Krijimi i mekanizmave për vetëvlerësim	44
4.6.6.	Adoptimi i politikave dhe politikave evropiane për shkollat promovuese të shëndetit	44
	PLANI I VEPRIMIT DHE BUXHETI	45

PËRMBLEDHJA E STRATEGJISË

Në vazhden e përmirësimit të cilësisë së jetës, qëndrimit në objektet shkollore, mësimdhënies, mësimnxënies dhe sigurisë e trajtimit të barabartë të të gjithë pjesëmarrësve në procesin mësimor, është shfaqur nevoja e hartimit të një strategjie gjithëpërfshirëse, të cilën e kemi quajtur si strategji të shkollave promovuese të shëndetit.

Për një kohë të gjatë shkolla dhe arsimi në Kosovë, me të gjitha elementet bashkëshoqëruese ose kanë qenë të lëna pas dore, ose ndaj tyre janë ushtruar trysni të ndryshme nga sistemet e mëparshme shtetërore. Kjo ka ndikuar që të trashëgojmë një sistem arsimi të vjetruar dhe të bazuar në ideologji, ku pjesa profesionale dhe infrastruktura tjetër kanë qenë në plan të dytë. Për shëndetin dhe mjedisin shkollor, thuhet nuk kishte përkujdesje në formë institucionale, kështu që mirëqenia sociale, fizike dhe emocionale e nxënësve dhe e personelit arsimor – ishte shpërfillur ose edhe ishte lënë pas dore tërësisht.

Bazuar në hulumtimin e bërë në muajin korrik 1999, 132 shkolla kanë qenë të dëmtuara tërësisht. Nga 596 shkolla të vlerësuara lidhur me ujin dhe gjendjen sanitare, 42 nuk kishin fare tualete dhe 380 i kishin tualetet jashtë ndërtesës shkollore në gjendje joadekuate, rreth 132 shkolla nuk kishin fare ujë. Nga ato shkolla që kishin furnizim me ujë, më shumë se gjysma ujin e kishin jashtë ndërtesës së shkollës.

IKSHP, i mbështetur nga UNICEF, në vitin 2002 organizoi një hulumtim të tillë në 40 shkolla në zona rurale të Kosovës, të cilat nuk janë të lidhura me sistemin e ujësjellësit. Nga ai hulumtim u konstatua se 75% të burimeve të ujit në shkolla të testuara, ishin të kontaminuara bakteriologjikisht dhe më shumë se 50% ishin të kontaminuara kimikisht. 80% e shkollave të testuara nuk kishin ujë të pijshëm.

Shumë donatorë nga qeveri të ndryshme, nëpërmjet organizatave që kanë zbatuar programe, kanë kontribuar në përmirësimin e gjendjes, dëmtimeve dhe ngecjeve në të gjitha sferat e jetës, sidomos në arsim. Edhe pse kontributi i tyre ishte i konsiderueshëm, nevojat kanë qenë shumëfish më të mëdha.

Në hulumtimet e bëra pas vitit 2000, përkitazi me njohuritë, sjelljet dhe praktikat për sa i përket konsumimit të duhanit, drogës dhe alkoolit, është konstatuar se një numër i madh i nxënësve, madje të moshës së re, kanë

filluar t'i konsumojnë të gjitha këto. Njëkohësisht, këto substanca abuzohen edhe në mjedise shkollore dhe jo vetëm nga nxënësit, po edhe nga punonjës të arsimit.

Njohuritë lidhur me HIV/AIDS-in dhe sëmundjet seksualisht të bartura, si dhe në përgjithësi për shëndetin riprodhues, janë në një shkallë të ulët, po edhe më kritike është shkalla e perceptimit të rrezikut nga infeksioni i mundshëm me këto sëmundje apo nga ndërprerja e shtatzënisë.

Bazuar në studimin e MASHT-së dhe UNICEF-it në Kosovë, mbi *Dhunën ndaj fëmijëve në shkolla, 2006*, Shumë nga fëmijët kanë deklaruar se ushtrues të dhunës janë njerëzit e afërt. Shumë prej tyre thonë se djemtë janë më të rrezikuar nga dhuna fizike, kurse vajzat janë më të rrezikuara nga keqpërdorimi verbal.

Duke filluar nga viti 2004 janë bërë përpjekje serioze, që, grupe ekspertësh të angazhuar nga disa ministri, si ajo e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, e Shëndetësisë, e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nga MKRS/Departamenti i Rinisë, nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, UNICEF-i, OBSH, IOM dhe individë të tjerë - ekspertë në fushën e edukimit, si dhe në fushën e shëndetit, - të përpilojnë një strategji për të mbështetur zhvillimin e mëtejshëm të konceptit dhe institucionalizimit të shkollave promovuese të shëndetit.

Është vendosur që Strategjia e hartuar të dinamizohet në dy faza: strategjia afatmesme, që do të përfshijë periudhën e parë të zbatimit dhe do të jetë 5-vjeçare, dhe strategjia afatgjatë, që do të përfshijë periudhën deri në fund të vitit 2018 .

Shëndeti gjithëpërfshirës shkollor sot përkufizohet si një qasje e integruar në promovimin shëndetësor, me qëllim të edukimit, informimit dhe sigurimit të mundësive për të krijuar qëndrime të drejta lidhur me shëndetin dhe për të mësuar e zbatuar sjellje të shëndosha.

Ky koncept ka për qëllim të ndërrojë jo vetëm sjelljet e nxënësve, po edhe të personelit arsimor dhe të mjedisit në të cilin këta nxënës jetojnë, mësojnë dhe punojnë.

Iniciativa e shkollave promovuese të shëndetit përcaktohet si program i promovimit shëndetësor në shkollë. Në këtë kuadër shkollat do të shfrytëzojnë parimet e përcaktuara në iniciativën e OBSH-së për shkolla

promovuese të shëndetit, do të marrin pjesë aktivisht dhe do të realizojnë programe që mbulojnë kurrikulet dhe mjediset e shkollave, përfshirë anëtarët e familjeve të nxënësve dhe bashkësinë në tërësi.

Objektivi i shkollave promovuese të shëndetit është që të përkrahen shkollat dhe të zhvillojë politika dhe programe efektive, që do të përforcojnë dhe do t'i bëjnë të shëndetshme dhe të qëndrueshme mjediset në të cilat zbatohen politikat dhe aktivitetet e tilla.

Koncepti i OBSH-së për shkollat promovuese të shëndetit është që të arrijë një jetesë në mënyrë të shëndetshme për tërë popullatën që kontakton me mjedisin shkollor, dhe të krijojë një mjedis përkrahës e ta shoqërojë atë me promovimin e shëndetit. Ky koncept krijon një mundësi, mirëpo kërkon edhe një zotim e angazhim, përgatitje, përmirësim shëndetësor, social dhe mjedis fizik adekuat. Në qendër të vëmendjes së shkollave që promovojnë shëndetin, janë të rinjtë.

Koncepti i shkollave "Mike për Fëmijët", i zhvilluar nga UNICEF-i, synon të kontribuojë në garantimin që të gjitha të drejtat e fëmijëve të respektohen dhe të monitorohen. Koncepti është zhvilluar brenda kornizës së përgjithshme të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës dhe të Konventës mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj femrave.

Koncepti i shkollave "Mike për Fëmijët" është bazuar në këtë politikë dhe ka pasur për qëllim të lehtësojë zhvillimin e qasjeve specifike vendore ndaj proceseve të përmirësimit të shkollave. Shkolla "Mike për Fëmijët" është përkufizuar si shkollë e shëndetshme, e efektshme dhe mbrojtëse, në të cilën familja dhe komuniteti përfshihen në mënyrë aktive .

Sot në shkollat e Kosovës, në programet e lëndëve për të gjitha klasat dhe moshat e fëmijëve, edukimi shëndetësor mund të trajtohet si lëndë e zgjedhur. Shkolla vendos, sipas zgjedhjes së nxënësve, se cilat nga temat në kuadër të edukimit shëndetësor rekomandohen të zgjidhen e të mësohen. Kjo mund të bëhet si lëndë a kurs i zgjedhur nga nxënësit, nëse për këtë deklarohen së paku 15 nxënës. Edukimi shëndetësor në programet lëndore të tjera trajtohet si pjesë ndërprogramore.

Vizioni

Një sistem efikas, brenda burimeve me të cilat disponohet, i cili siguron mjedis shkollor të hapur dhe nxitës për pjesëmarrje aktive, ku secili e ndien veten të sigurt, të barabartë e të lumtur, mjedis i cili do të jetë i gatshëm për adoptimin e standardeve të pranuar ndërkombëtare.

Misioni

Sigurimi i mjedisit shkollor të shëndetshëm dhe miqësor, të sigurt përmes edukimit shëndetësor, promovimit të mbrojtjes së mjedisit dhe forcimit të partneritetit ndërmjet shkollës, prindërve dhe komunitetit.

Objektivat strategjikë

Gjatë procesit të përpilimit të strategjisë së shkollave promovuese të shëndetit, grupet e ekspertëve në fusha të ndryshme identifikuan 6 objektiva strategjikë, të cilët duhet të arrihen në periudhën e paraparë. Këta objektiva janë:

4.1. Mjedis i shëndetshëm dhe përkrahës nga ana e mësimitdhënësve, nxënësve dhe prindërve.

4.2. Mjedis fizik i përshtatshëm dhe i shëndetshëm për mësimitdhënie e mësimitnxënie

4.3. Kapacitete të mjaftueshme njerëzore dhe materiale

4.4. Përkujdesje cilësore dhe e vazhdueshme për shëndetin e nxënësve

4.5. Shkallë e ulët e dhunës në shkollë

4.6. Nivel i kënaqshëm i kulturës shëndetësore dhe mjedisore tek nxënësit

Në mënyrë që realizimi i objektivave të ndiqet dhe të verifikohet, janë përcaktuar edhe treguesit përkatës. Po ashtu, për të arritur objektivat e përcaktuar, janë saktësuar edhe aktivitetet e nevojshme, përmes të cilave do të realizohet edhe strategjia e shkollave promovuese të shëndetit. Praktikisht, aktivitetet e përcaktuara mund të konsiderohen edhe si projekte të veçanta në zhvillimet e mëtejme të zbatimit të strategjisë.

1. HYRJE

1.1. Arsyja për përpilimin e strategjisë së shkollave promovuese të shëndetit

Për një kohë të gjatë shkolla dhe arsimit në Kosovë, me të gjitha elementet bashkëshoqëruese, ose kanë qenë të lëna pas dore, ose ndaj tyre janë ushtruar trysni të ndryshme nga sistemet e mëparshme shtetërore. Kjo ka ndikuar që të trashëgojmë një sistem arsimit të vjetruar dhe të bazuar në ideologji, ku pjesa profesionale dhe infrastruktura tjetër kanë qenë në plan të dytë. Shumica e objekteve shkollore, orendive dhe mjeteve të tjera didaktike, kanë qenë të vjetruara dhe jo në harmoni me standardet pedagogjike dhe shëndetësore të njohura botërisht.

Për shëndetin dhe mjedisin shkollor, thuhet se nuk kishte përkujdesje në formë institucionale, kështu që mirëqenia sociale, fizike dhe emocionale e nxënësve dhe e personelit arsimor – ishte shpërfillur ose edhe ishte lënë pas dore tërësisht.

Bazuar në hulumtimin e bërë në muajin korrik 1999, 132 shkolla kanë qenë të dëmtuara tërësisht. Nga 596 shkolla të vlerësuara lidhur me ujin dhe gjendjen sanitare 42 nuk kishin fare tualete dhe 380 i kishin tualetet jashtë ndërtesës shkollore në gjendje joadekuate, rreth 132 shkolla nuk kishin fare ujë. Nga ato shkolla që kishin furnizim me ujë, më shumë se gjysma, ujin e kishin jashtë ndërtesës së shkollës.

Bazuar në vlerësimin e gjendjes së arsimit, të organizuar menjëherë pas luftës, është rekomanduar të bëhet hulumtimi lidhur me kontrollin e ujit në shkolla dhe si rezultat i kësaj, IKSHP, i mbështetur nga UNICEF, në vitin 2002 organizoi një hulumtim të tillë në 40 shkolla në zona rurale të Kosovës, të cilat nuk janë të lidhura me sistemin e ujësjellësit. Nga ky hulumtim u konstatua se 75% të burimeve të ujit në shkolla të testuara, ishin të kontaminuara bakteriologjikisht dhe më shumë se 50% ishin të kontaminuara kimikisht. 80% e shkollave të testuara nuk kishin ujë të pijshëm. Pikërisht ky hulumtim dhe këto konkluzione, qenë shkak që Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të inicionte ngritjen e një organi ndërmënisht, i cili do të bënte një plan veprimi për ta adresuar këtë çështje.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është informuar për situatën në vitin 2003, në mënyrë që të avokonte tek donatorët potencialë për të realizuar

një furnizim më efikas dhe të shëndoshë në institucionet arsimore të Kosovës. Për shkak të mundësive të kufizuara financiare dhe orientimeve e interesimeve drejt objektivave të tjerë të vendimmarrësve dhe donatorëve, nuk u arrit të bëhej më shumë për shkollat që kishin probleme me ujë të pijshëm.

Kjo situatë alarmante lidhur me ujin e pijshëm, që vë në rrezik të lartë dhe të vazhdueshëm të gjithë pjesëmarrësit brenda institucioneve arsimore, po edhe bashkësinë me një potencial të lartë të shpërthimit të epidemive hidrike, që do të merrnin dimensione të mëdha bazuar në numrin e lartë të nxënësve në shkollat kosovare, është edhe një ndër arsytet shtesë që koncepti i shkollave promovuese të shëndetit të bëhet program i qeverisë së Kosovës.

Kjo gjendje ka ndikuar që të mobilizohen faktorët e rëndësishëm (vendimmarrës) për përmirësimin e situatës në shkollën dhe arsimin kosovar. Shumë donatorë nga qeveri të ndryshme, përmes organizatave, që kanë zbatuar programe, kanë kontribuar në përmirësimin e gjendjes, riparimin e dëmtimeve dhe përballimin e nevojës në të gjitha sferat e jetës, sidomos në arsim. Edhe pse kontributi i tyre ishte i konsiderueshëm, nevojat kanë qenë shumë më të mëdha. Me qëllim të krijimit të kushteve optimale për shkollim sa më efikas të qytetarëve të Kosovës, vazhdojnë të bëhen përpjekje që ky shkollim optimal të arrihet përmes krijimit të një mjedisi, i cili do të promovonte shëndetin si atribut kryesor të pjesëmarrësve në procesin e mësimin. Kjo duke filluar që nga nxënësit, pedagogët dhe prindërit a kujdestarët e deri tek bashkësia si përfutuese përfundimtare.

Në hulumtimet e bëra pas vitit 2000 përkitazi me njohuritë, sjelljet dhe praktikat për sa i përket konsumimit të duhanit, drogës dhe alkoolit, është konstatuar se një numër i madh i nxënësve, madje edhe të moshës së re, kanë filluar t'i konsumojnë të gjitha këto, duke dëmtuar shëndetin dhe reduktuar në maksimum procesin e formimit të tyre si qytetarë të vlefshëm e të shëndoshë. Njëkohësisht, këto substanca abuzohen edhe në mjediset shkollore, dhe kjo jo vetëm nga nxënësit, po edhe nga punonjësit e arsimit.

Njohuritë lidhur me HIV/AIDS-in, sëmundjet seksualisht të bartura dhe në përgjithësi me shëndetin riprodhues janë në nivel të ulët, po edhe më kritike është shkalla e perceptimit të rrezikut nga infeksioni i mundshëm me këto sëmundje apo nga ndërprerja e shtatzënisë.

Bazuar në studimin e MASHT-së dhe UNICEF-it në Kosovë, mbi *Dhunën ndaj fëmijëve në shkolla, 2006*, Shumë nga fëmijët kanë deklaruar se ushtrues të

dhunës janë njerëzit e afërt. Shumë prej tyre thonë se djemtë janë më të rrezikuar nga dhuna fizike, kurse vajzat janë më të rrezikuara nga keqpërdorimi verbal.

Në përgjithësi, për fëmijët e moshave 6-11 vjeç, rruga është konsideruar si vendi më i dhunshëm, dhe përafërsisht 75% e tyre deklarojnë se dhuna ka ndodhur aty; 27% thanë se shkolla ishte skena e ngjarjeve të dhunshme dhe 12% e përmendën shtëpinë; 37% e fëmijëve më të rritur në moshë dhunën ndaj fëmijëve në shkolla e konsideronin si një dukuri të përhapur në Kosovë; 6% e fëmijëve të moshës prej 11-18 vjeç deklarojnë të kenë përjetuar dhunë seksuale nga mësimdhënësit, kurse 7% e fëmijëve të moshës 6-12 vjeç kanë pranuar se kanë qenë dëshmitarë të rasteve të ngacmimeve seksuale.

Këto hulumtime të shoqëruara me informata shëndetësore të përditshme, shtrojnë nevojën që të përpilohen dokumente dhe të ndërmerren veprime me qëllim të parandalimit, trajtimit dhe zvogëlimit të potencialit kërcënues të gjithë këtyre dukurive dhe problemeve, që godasin gjithnjë e më shumë individin, shkollën dhe komunitetin.

Duke filluar nga viti 2004 janë bërë përpjekje serioze, që, grupe ekspertësh të angazhuar nga disa ministri, si ajo e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, e Shëndetësisë, e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nga MKRS/Departamenti i Rinisë, nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës, UNICEF-i, OBSH, IOM dhe individë të tjerë - ekspertë në fushën e edukimit, si dhe në fushën e shëndetit, - të përpilojnë një strategji për të mbështetur zhvillimin e mëtejshëm të konceptit dhe institucionalizimit të shkollave promovuese të shëndetit.

Kjo strategji e re duhet të bazohet në strategjitë tanimë të zhvilluara për arsimin, shëndetësinë, mjedisin, planin e aksionit për rininë dhe dokumentet e tjera me rëndësi, që kanë të bëjnë me përkrahjen e koncepteve dhe filozofisë që ofron koncepti i gjerë i shkollave promovuese të shëndetit. Natyrisht që kjo fazë nuk qe mundur të arrihej menjëherë, duke pasur parasysh edhe situatën emergjente të arsimit në Kosovë pas vitit 1999, si dhe shkatërrimit serioz që iu bë tërë Kosovës dhe sidomos sistemit arsimor qysh nga viti 1981. Shkollat në shumë vendbanime ishin shkatërruar a dëmtuar deri në atë shkallë, sa që ishte e pamundur të zhvillohej qoftë dhe procesi më i thjeshtë i edukimit, dhe të krijohej një mjedis, i cili do të promovonte shëndetin e të gjithë

pjesëmarrësve në edukim dhe atë të bashkësisë, e cila parimisht e ka detyrim të realizojë këto parakushte

Nga viti 2003 filloi të funksiononte Komiteti i shkollave promovuese të shëndetit, një organizëm multidisiplinar. Më vonë, në vitin 2005, me vendimin që mori Qeveria e Kosovës, aty u inkuadrua, si staf civil, një koordinator, i cili bashkërendonte aktivitetet e komitetit. Ndërkohë komiteti vazhdoi të udhëhiqej nga pjesëtarët e tij me sistemin e rotacionit. Koordinatori u vendos të vepronte në kuadër të MASHT-së, por për punën e vet t'u raportonte tri ministrive: MASHT, MSh dhe MMPH. Duhet nënvizuar se në komitet, që nga formimi i tij, ka dhënë kontribut edhe përfaqësuesi i Departamentit të Rinisë (MKRS).

Gjatë vitit 2006 është organizuar punësoria me qëllim të përcaktimit të drejtimit nga duhej zhvilluar strategjia e ardhshme për shkollat promovuese të shëndetit. Kjo kornizë, e zhvilluar me pjesëmarrjen aktive të të gjitha strukturave zyrtare dhe individëve të interesuar, është përpiluar si e tillë, për të zbatuar parimet themelore të shkollave promovuese të shëndetit në Kosovë, bazuar edhe në mundësitë lokale si dhe respektimin e burimeve njerëzore e financiare dhe infrastrukturën shoqëruese.

Është vendosur që Strategjia e hartuar të dinamizohet në dy faza:

1. Strategjia afatmesme, që do të përfshijë periudhën e parë të zbatimit dhe do të jetë 5-vjeçare, dhe
2. Strategjia afatgjatë, që do të përfshijë periudhën deri në fund të vitit 2018.

Kjo ndarje është bërë për t'u lënë mundësi zbatuesve dhe drejtuesve të Strategjisë, që të bëjnë korrigjime brenda saj, duke u bazuar në vlerësimet, të brendshme e të jashtme, që do t'i bëhen eventualisht këtij dokumenti në periudha të caktuara kohore.

Gjatë fundit të vitit 2006 janë realizuar edhe 2 punëtori njëditore me pjesëmarrje të niveleve që prej atyre vendimmarrëse e deri tek ato që do të zbatojnë drejtpërsëdrejti Strategjinë, në mënyrë që të mund të bëheshin ndërhyrje të drejtpërdrejta në draftin e parë të Strategjisë të bazuar në Kornizën e krijuar në punëtorinë e parë, në fillim të vitit 2006.

1.2. Të dhënat demografike, sociale dhe ekonomike themelore për Kosovën dhe konteksti historik i zhvillimit të arsimit në Kosovë para vitit 1999

Kosova është një vend i Evropës Juglindore, që ka një sipërfaqe prej 10887 km² dhe afro 2.2 milionë banorë. Shumicën e popullatës e përbëjnë Shqiptarët (rreth 88%). Nga minoritetet, Serbët janë me numrin më të madh, përafërsisht 7%, pjesa tjetër, afro 5% janë minoritetet e tjera: Turq, Boshnjakë, Goranë, Ashkalinj, Romë, Egjiptianë dhe Kroatë. Popullata e Kosovës është e re, afro 50% janë më të rinj se 20 vjeç ose 60% të popullsisë janë të moshës 0-25 vjeç. Struktura e moshës së popullatës është kjo: të grupmoshës prej 0-6 vjeç janë 428791 ose 18.0%, prej 7-19 vjeç janë 714651 ose 30.0%, prej 0-19 vjeç janë 1143442 ose 48.0%; 37.35% të popullsisë së gjithmbarshme i takon grupmoshës prej 0-14 vjeç, 57.85% nën moshën 25 vjeç dhe vetëm 4.44% e popullatës janë mbi 65 vjeç. Femrat e moshës fertile (15-49 vjeç) marrin pjesë me 23%, kurse moshë mesatare e popullatës është 25 vjeç.

Pas Luftës së Dytë Botërore, pa vullnetin e popullit të saj, Kosova mbeti nën administrimin e ish-Jugosllavisë, sa kohë që popullata e saj fitoi disa të drejta për t'u shkolluar. Në atë kohë nuk kishte një sistem të mirëfilltë të arsimit në Kosovë dhe e gjithë politika arsimore udhëhiqej nga Beogradi dhe, për pasojë, popullata në masën më të madhe ishte e pashkolluar. Fillimisht në Kosovë kishte 57120 nxënës e 777 arsimtarë, dhe shumica e të cilëve ishin Serbë.

Me kalimin e viteve, Kosova po fitonte disa të drejta në sistemin e arsimit për të fituar në vitin 1970 të drejtën të themelonte Universitetin e parë të Kosovës. Në vitin 1980 sistemi i arsimit i Kosovës numëronte 358521 nxënës e studentë dhe 17751 arsimtarë dhe punëtorë tjerë të arsimit.

Zhvillimi i arsimit në të gjitha nivelet si dhe zhvillimi i gjithmbarshëm i shoqërisë kosovare u ngulfat dhe u ndalua nga Qeveria e Beogradit në vitin 1989, kur ajo suprimoi autonominë e Kosovës.

Me këtë veprim që ndërprerë zhvillimi dhe mundësia për të ndërmarrë reforma sistemore, të cilat zinin vend në tërë botën.

Gjatë periudhës 1989/1999, në shumë sfera publike në Kosovë u zhvillua i ashtuquajti "Sistem paralel", dhe në ato rrethana edhe sistemi arsimor u organizua nëpër strukturat e veta paralele në të gjitha nivelet. U krijuan

mekanizmat e kundërvënies në rrugë institucionale, nëpërmjet përfaqësueseve legjitimë të popullit dhe për të realizuar synimet, u ndërtuan strukturat e sistemit të pavarur të arsimit nën udhëheqjen e Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës në mërgim, dhe Lidhjes së Arsimitarëve Shqiptarë të Kosovës.

Në vitin 1991 u vendos të punohej në një sistem të pavarur të arsimit, kur në Kosovë kishte 452 shkolla të plota fillore, 67 shkolla të mesme, 1 universitet me 14 fakultete e 7 shkolla të larta, - me gjithsej afro 400.000 nxënës e studentë dhe 21.000 punonjës të arsimit.

Ai ishte organizimi më i veçantë në botë, i funksionimit të një sistemi të arsimit për 10 vjet me radhë nën kushte të okupimit klasik ushtarak, kur pësuan shumë nxënës, studentë, prindër, punonjës dhe udhëheqës të arsimit në Kosovë.

Me gjithë pengesat dhe dhunën e ushtruar, Sistemi i Pavarur i Arsimit i Kosovës arriti qëllimet, që:

- Të ruante funksionimin e institucioneve dhe vazhdimësinë e procesit të arsimit;
- Të mbante financiarisht nxënësit, studentët, punonjësit e arsimit dhe familjet e tyre në Kosovë dhe të pengonte largimin e popullatës në përmasa të mëdha;
- Të shërbente si brumë apo komponenti kryesor i ndërtimit të institucioneve të mirëfillta të shtetit të Kosovës dhe t'i kundërvihej me sukses tentimit të regjimit serb për krijimin e një sistemi të imponuar serb të arsimit në Kosovë.
- Të zhvillonte plane dhe programe mësimore të reja, pa ndikime ideologjike, si dhe të botonte tekste shkollore në bazë të planeve dhe programeve të reja.

Mirëpo, krahas shumë rezultateve pozitive që u arritën në këtë fushë, zhvillimi i arsimit në Kosovë, për një kohë të gjatë në kushte jonormale, dhe sidomos në kushtet e përshkallëzimit të luftës në vitin 1999, pati për pasojë:

- Shkëputjen e sistemit të arsimit nga rrjedhat normale;
- Pa mundësinë e arsimtarëve që të përgatiteshin në përputhje me kërkesat e qasjeve të reja në arsim, edhe pse as në rajon nuk kishte ndodhur diçka e avancuar dhe

- Shkatërrimin e infrastrukturës dhe objekteve shkollore.

Megjithatë, përfitimet nga politika e organizimit të sistemit të pavarur të arsimit në Kosovë, ishin shumë më të mëdha sesa pasojat negative, që solli ajo.

Nga viti 1998 fillon lufta në mes të popullatës shqiptare, e udhëhequr nga UÇK, dhe forcave militare e paramilitare serbe. Kjo luftë do ta arrinte kulmin në mars të vitit 1999, kur filluan edhe veprimet ushtarake të forcave të NATO-s.

Konfliktit i parapriu edhe një dëbim masiv me dhunë nga Kosova i afro 1 400 000 banorëve të Kosovës, kryesisht shqiptarë.

Nga përfundimi i luftës, Kombet e Bashkuara nxorën Rezolutën 1244, e cila krijoi një protektorat dhe qeverisje ndërkombëtare, të kombinuar me faktorin vendor. Që nga ajo kohë në Kosovë janë ende të pranishme strukturat e NATO-s, përmes KFOR-it si fuqi ushtarake dhe UNMIK-u si strukturë administrative ndërkombëtare. Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse (IPVQ) kanë pasur autonomi të konsiderueshme në vendimmarrje. Autoriteti më i lartë arsimor i IPVQ-së ishte Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Zyrtarisht, Kosova ishte e ndarë në 30 komuna.

Shumica e popullatës, pas mbarimit të luftës dhe arritjes së forcave të NATO-s, janë kthyer në Kosovë, por jo të gjithë në shtëpitë e veta.

Sipas raporteve të Bankës Botërore, mbi 40% e popullatës jeton në varfëri dhe 12% e popullatës jeton në varfëri të skajshme. Një pjesë e të mirave ekonomike, akoma sigurohen nga familjarët që jetojnë jashtë vendit, në Diasporë.

Disa nga indikatorët socialë demografikë të Kosovës

Indikatorët	Vlera
Popullata	2,382,000
Dendësia e përgjithshme (banorë për km ²)	218
Popullata urbane	37%
Shtimi vjetor i popullatës	2.1%
Femrat që mbajnë shtëpinë	10%
Popullata e moshës nën 20 vjeç	48%
Fëmijë (0- 19)	F=23% M=25%
Mosha e aftë për punë (20 - 64)	F=23% M=24.5%
Popullata e moshuar (65+)	F=2.4% M=2.1%
Mosha mesatare e pritur e jetesës (të lindurit 1990-1995)	72.0
Meshkuj	71.5
Femra	76.6
% e amvisërive me rrymë elektrike	92%
% e amvisërive me tualet brenda njësisë banesore	28%

Kushtet sociale, kulturore si dhe ato të sjelljeve kanë ndërruar mjaft pas vitit 1999, sidomos në pjesën urbane, më pak në atë rurale.

Barazia gjinore ka filluar të marrë një dimension të ri në Kosovë, me përpjekjet që gruan ta vërë në pozitë të barabartë në shumë sfera të jetës.

Kushtet sociale dhe ato ekonomike vazhdojnë të bëjnë presion tek shumë të rinj dhe familje të tëra, që të provojnë të migrojnë jashtë Kosovës. Ka po ashtu edhe tentime për të braktisur shkollimin e rregullt, një dukuri kjo më e shpeshtë për vajzat.

1.3. Situata aktuale në arsimin e Kosovës

Sipas statistikave, në bankat shkollore sot gjenden afro ¼ ose 1/5 e numrit të përgjithshëm të banorëve.

Për mungesë të regjistrimit të popullsisë, nuk kemi të dhëna për numrin e përgjithshëm të fëmijëve, por mund të diskutojmë për përfshirjen e fëmijëve në institucionet arsimore në Kosovë (sa nxënës kemi përfshirë në shkollim). Prej mbi 2 milionë banorësh, sa ka Kosova, në sistemin arsimor ka mbi 450.000 nxënës.

1.3.1. Sistemi administrativ

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është përgjegjëse për formulimin, përpilimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive në lëmin e arsimit.

Kjo ka të bëjë edhe me një pjesë të financimit, që sigurohet nga Buxheti i Kosovës, nga ana e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

MAShT, duke realizuar procesin e decentralizimit të pushtetit, ka edhe 7 Zyra Rajonale të Arsimit, që udhëhiqen nga zyrtarë rajonale të arsimit, dhe 30 njësi brenda komunave, të emëruara si Drejtori të arsimit, të udhëhequra nga drejtorë komunalë të arsimit. Drejtoritë komunale u përgjigjen Kuvendeve komunale, gjegjësisht pushtetit lokal, kurse Zyrat Rajonale Ministrisë.

Në aspektin financiar, MAShT obligohet të përkujdeset për çështjet lidhur me kurrikulet dhe trajnimin e personelit arsimor, kurse drejtoritë komunale përkujdesen për mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore.

1.3.2. Sistemi i shkollimit parauniversitar

Në Kosovë sistemi themelor i shkollimit është i ndarë në arsimin fillor, i cili përfshin klasën I deri në të 5-n, pastaj në arsimin e mesëm të ulët, që përfshin klasën e 6 e deri në të 9 –n dhe në arsimin e mesëm të lartë, që përfshin klasat nga e 10– ta deri tek e 12 – ta, respektivisht për shkollat profesionale deri tek klasa e 13.

Shkollimi është i detyrueshëm për të gjithë deri në klasën e 9.

Vlen të përmendet edhe fakti se, përveç këtyre sistemi i institucioneve parashkollore për fazën e shkollimit i përgatit fëmijët e moshave mbi 3 vjeç deri në fillimin e shkollimit të rregullt të tyre, dhe po ashtu ofron edukim shëndetësor, shkathtësi për jetë dhe arsimim bazë.

Përfshirja në vitin shkollor 2005-2006, sipas të dhënave, është si vijon:

Në institucionet parashkollore (43 objekte) kemi përfshirë 5191 fëmijë prej 9 muajsh e deri sa të mbushin 5 vjeç, ndërsa të moshës 5 deri 6 vjeç afro 20.750 fëmijë. Në institucionet parashkollore private, janë disa institucione të licencuara, dhe disa objekte në procedurën e licencimit. Ekzistojnë edhe QBK-të (Qendrat me Bazë në Komunitet), që përfshijnë viset rurale, pikërisht 35 qendra me 900 fëmijë.

Në shkollat fillore dhe të mesme kemi këtë përfshirje: Në mbi 1100 shkolla fillore (shkollat amë dhe paralelet e ndara), sa ka Kosova, mësimin fillor dhe të mesëm të ulët e vijnë 322.180 nxënës, kurse 74.781 nxënës vijnë mësimin në 108 shkolla të mesme të larta (amë dhe paralelet e ndara - vartëse) të Kosovës. Ekzistojnë edhe 11 shkolla private të niveleve të ndryshme të arsimit parauniversitar.

Arsimi special - supozohet se në Kosovë, bazuar në të dhënat e Njesisë së Arsimit Special dhe FSDEK-së, ka afro 40.000 persona me nevoja të veçanta, prej tyre 12.000 fëmijë të moshës shkollore me dëmtime të lehta, - 884 nxënës janë përfshirë në 7 shkolla .

1.3.3. Infrastruktura e shkollave në periudhën pas vitit 1999

Arritjet

U deshën investime domethënëse të donatorëve të shumtë ndërkombëtarë, të institucioneve vendore, po edhe investime të komunitetit, për të mundësuar një fillim në kushte relativisht normale të vitit shkollor 1999 – 2000. Donatorët ndërkombëtarë, të prirë nga UNICEF-i, nga Agjencia Evropiane për Rindërtim (në fillim ECHO), dhe donatorë të tjerë, si Banka Islamike për Zhvillim dhe shtete të veçanta, si Gjermania, Zvicra, Holanda, Danimarka, Japonia, e të tjerë, investuan shuma të konsiderueshme për të krijuar kushte fizike për organizimin e mësimin pas shkatërrimeve të fundit të viteve nëntëdhjetë dhe mungesës së çfarëdo mirëmbajtjeje nga shteti në shkollat kosovare për më se njëzet vjet. Këto përpjekje, së bashku me pajisjen e shkollave me mjete të ndryshme dhe me teknologji informative, si dhe zhvillimi i programeve për promovimin e shkollave të shëndetshme, ndikuan në përmirësimin e mjedisit për mësimdhënie dhe mësimnxënie dhe, si rezultat i kësaj, edhe për krijimin e parakushteve për mësim më cilësor. Më vonë u shtuan përpjekjet për përmirësimin e infrastrukturës fizike për të plotësuar kërkesat e fëmijëve me nevoja të veçanta, në përputhje me politikën për arsim gjithëpërfshirës. Pas vitit 2002 kishte një zhvendosje graduale të barrës së investimeve për sigurimin e infrastrukturës fizike nga donatorë të ndryshëm tek institucionet vendore. Në periudhën 2002-2005 MASHT ka financuar rinovimin e 39 objekteve shkollore, me vlerë të përgjithshme 1,8 milion €, dhe ndërtimin e 28 objekteve të reja shkollore, me vlerë më shumë se 8 milionë €.

Dobësitë

Të gjitha këto përpjekje gradualisht përmirësuan dukshëm kushtet fizike të mësimit në arsimin kosovar. Megjithatë, deri në vitin 2002 këto investime janë bërë vetëm në bazë të kërkesave të komunitetit dhe në bazë të vlerësimit të organizatave të ndryshme donatore. Në atë kohë mungonte një qasje e planifikuar dhe sistematike e trajtimit të problemit të infrastrukturës shkollore. Një përjashtim ishte baza e të dhënave e krijuar nga Grupi Ndërkombëtar i Menaxhimit (IMG), agjenci e financuar nga Bashkimi Evropian, ku janë përfshirë të gjitha objektet shkollore sipas incizimit në vitin 1999. Kësisoj, shumica e shkollave të ndërtuara pas luftës, u ndërtuan në vendet e shkollave të vjetra të kohës para luftës. Kishte edhe raste ekstreme, kur nuk ishte marrë parasysh lëvizja e popullatës nga një zonë (kryesisht rurale) dhe shkolla e re ishte ndërtuar për nevoja të një numri shumë të vogël nxënësish. Një shpërputhje e tillë ndërmjet lëvizjeve demografike dhe ndërtimit e renovimit të shkollave, kishte ndodhur në pjesë të shumta të Kosovës dhe, rrjedhimisht, disa qytete përfunduan me shkolla të mbingarkuara dhe me mësim në më shumë se dy ndërresa, sa kohë që në disa fshatra kishte hapësirë për zhvillim të mësimit tërëditor. Për mungesë të një veprimi të organizuar, po ashtu kishte raste të instalimit të kompjuterëve dhe teknologjisë moderne në objekte shkollore që kishin mungesë të vazhdueshme të rrymës elektrike.

Në anën tjetër, kishte lëshime të shumta edhe në mënyrën e mirëmbajtjes dhe menaxhimit të objekteve të reja shkollore, bashkëpunim të pamjaftueshëm të bashkësisë, procedura të ndërlikuara të menaxhimit financiar e të prokurimit, mungesa buxhetore për mirëmbajtje e menaxhim, menaxhim të gabuar ose keqmenaxhim të mjeteve dhe pajisjeve të siguruara, e të tjera, të cilat kanë ndikuar në rënien e efektit të investimeve të konsiderueshme në këtë sektor dhe në rënien e cilësisë së punës, për shkak të infrastrukturës fizike.

Një situatë e këtillë kërkon përpjekje të planifikuara mirë për të maksimizuar efektin e mjeteve të investuara pas luftës dhe për të prodhuar sa më shumë cilësi në shërbimet arsimore për njësi të mjeteve të investuara. S'do mend që sigurimi i kushteve më të mira teknologjike dhe zgjerimi i hapësirës fizike, do të ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së mësimit. Planifikimi i masave për sigurimin e mësimit në së paku dy ndërresa deri në vitin 2010, dhe sigurimi i zhvillimit të balancuar teknologjik e infrastrukturor në mes të zonave rurale

dhe urbane, - mbeten dy sfidat kryesore të kësaj strategjie dhe të punës së institucioneve arsimore në periudhën e ardhshme afatmesme.

Këto probleme, së bashku me prioritizimin më të madh të teknologjisë informative në procesin mësimor, janë trajtuar nga grupi përkatës dhe janë propozuar masa konkrete për përmirësimin e situatës, në mënyrë që, infrastruktura dhe teknologjia informative, përfundimisht, të jenë në funksion të drejtpërdrejtë të ngritjes së cilësisë.

1.4. Parimet dhe konceptet aktuale të shkollave Promovuese të shëndetit në botë dhe ato që sigurojnë një mjedis të shëndoshë

Sot në botë ekzistojnë shumë qasje që lidhen me faktin se çfarë në të vërtetë duhet të jetë shkolla e cila do ti plotësojë të gjitha kushtet ose shumicën e tyre, që të përmbushë elementet kyçe të shkollave promovuese të shëndetit.

Duke qenë se në vetë emërtimin po përmenden edhe shëndeti edhe promovimi i tij, duhet të japim disa përkufizime lidhur me këtë.

Shëndeti gjithëpërfshirës shkollor sot përkufizohet si një qasje e integruar në promovimin shëndetësor me qëllim të edukimit, informimit dhe sigurimit të mundësive për të krijuar qëndrime të drejta lidhur me shëndetin dhe për të mësuar e zbatuar sjellje të shëndosha.

Ky koncept ka për qëllim të ndërrojë jo vetëm sjelljet e nxënësve, po edhe të personelit arsimor, të mjedisit në të cilin këta nxënës jetojnë, mësojnë dhe punojnë.

Përkufizimi i shkollës brenda këtij koncepti është gjithashtu më gjithëpërfshirës dhe përfshin në vete jo vetëm institucionin që ofron edukimin primar dhe sekondar të nxënësve të moshës deri në moshën 19 vjeç, por edhe të gjitha ato që, si programe, zhvillohen duke u bazuar në procesin e shkollimit pa marrë parasysh se a i shfrytëzojnë hapësirat shkollore. Po ashtu, ky zhvillim i programeve mund të përfshijë në vete edhe personelin arsimor e prindërit, por edhe të gjithë pjesëmarrësit nga bashkësia, që dëshirojnë t'u bashkohen aktiviteteve programore.

Promovimi shëndetësor në shkollë përkufizohet si: programe që shpien drejt përmirësimit, përparimit dhe ruajtjes së shëndetit, por edhe identifikim dhe trajtim me kohë i sëmundjeve apo devijimeve që shkaktojnë dëmtimin e shëndetit të pjesëmarrësve në procesin mësimor.

Iniciativa e shkollave promovuese të shëndetit përkufizohet si program i promovimit shëndetësor në shkollë, në mënyrë që shkollat të shfrytëzojnë parimet e përcaktuara në iniciativën e OBSH-së për shkolla promovuese të shëndetit, dhe të merrnin pjesë e të realizonin aktivisht programe, të cilat mbulojnë programe mësimore në shkollë, dhe mjediset shkollore, duke përfshirë anëtarët e familjeve të nxënësve dhe bashkësinë në tërësi.

Procesi i shkollave promovuese të shëndetit siguron që shkollat të përkujdesen për mjedisin ku mirëqenia sociale fizike, mentale, shëndeti dhe siguria e të gjithë pjesëmarrësve në proces arsimor, të përkrahjet në formë partneriteti me familjen, bashkësinë dhe pjesëmarrësit qeveritarë e joqeveritarë të bashkësisë. Shkollat e tilla mund të krijojnë aleanca të gjera duke u inkuadruar në rrjete të shkollave promovuese të shëndetit në Evropë.

Objektivi i shkollave promovuese të shëndetit është që të përkrahen shkollat dhe të zhvillohen politika e programe efektive, të cilat do të përforconin dhe t'i bënin të shëndetshme e të qëndrueshme mjediset në të cilat zbatohen politikat dhe aktivitetet e tilla.

Për të ndjekur realizimin e proceseve të shkollave promovuese të shëndetit, bëhet kontrolli dhe përcjellja e vazhdueshme e veprimtarisë me qëllim që të përcaktohen nivelet, efektiviteti dhe cilësia e proceseve të:

- Karakterit dhe mjedisit shkollor
- Cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies
- Cilësisë së menaxhimit të tërë procesit duke përqafuar edhe lidhjet e realizuara me familjet, bashkësinë dhe individë e asociacione me ndikim

Duke ndjekur cilësinë e zbatimit, njëkohësisht realizohet një proces më i suksesshëm i mësimdhënies dhe mësimnxënies si dhe bëhen më të efektshme zhvillimet, avancimet dhe ndërhyrjet në politikat e shkollave, duke pasur si cak realizimin e një mjedisi që siguron progres të gjithmbarshëm.

1.4.1. Koncepti dhe kriteret e shkollave promovuese të definuara sipas OBSH-së

Koncepti i OBSH-së për shkollat promovuese të shëndetit, është që të arrijë një mënyrë jetese të shëndoshë për tërë popullatën dhe mjedisin shkollor duke krijuar një ambient përkrahës që do të rezultojë me promovim të

shëndetit. Ky koncept krijon një mundësi, por kërkon edhe një zotim e angazhim, përgatitje, përmirësim shëndetësor e social dhe mjedis fizik adekuat. Në qendër të vëmendjes së shkollave që promovojnë shëndetin, janë të rinjtë.

Shkollat që promovojnë shëndetin, inkurajojnë sjellje të shëndosha dhe njëkohësisht e bëjnë të njohur faktin që përgjegjësia për përmirësimin e shëndetit, nuk varet vetëm nga individi, por është një përgjegjësi me pjesëmarrje të përbashkët të të gjithë pjesëtarëve të bashkësisë që promovon shëndetin.

Kriteret për shkollat promovuese të shëndetit, kanë të bëjnë me këto kërkesa:

- Shkollat promovuese të shëndetit duhet të sigurojnë një mjedis të sigurt dhe stimulues, i cili do të nxitë nxënësit dhe të gjithë pjesëmarrësit në procesin e realizimit të mësimin, që të jenë të shëndetshëm dhe të sigurt, si brenda ashtu edhe jashtë shkollës.
- Shkollat promovuese të shëndetit duhet të promovojnë vetërespektin dhe vetëbesimin përmes sigurimit të mundësive të të gjithë pjesëmarrësve në procesin e mësimin dhe të bashkësisë shkollore, që të kontribuojnë në jetën shkollore, duke i aftësuar ata të marrin iniciativa, të bëjnë përzgjedhje dhe të mbajnë përgjegjësinë për shëndetin e vet dhe të tjerëve.
- Shkollat promovuese të shëndetit duhet të krijojnë një mjedis brenda hapësirave shkollore, i cili krijon miqësi, respekt dhe konsideratë për të tjerët, në mënyrë që t'u mundësohet, si individëve ashtu edhe grupeve të interesit, që të kontribuojnë përmes shkathtësive dhe cilësive që disponojnë.
- Shkollat promovuese të shëndetit duhet të formulojnë, të rishqyrtojnë dhe të zbatojnë rregullisht politika të ndryshme lidhur me çështjet që ndërlidhen me shkollat promovuese të shëndetit dhe me nxënësit e personelin arsimor, duke u mbështetur tek qëllimet dhe objektivat e shkollës.
- Shkollat promovuese të shëndetit duhet të planifikojnë dhe të zbatojnë kurrikule që promovojnë shëndetin dhe mirëqenien, që janë në pajtim

me kërkesat e njohura me ligj dhe në të cilat kanë qasje të gjithë nxënësit.

- Shkollat promovuese të shëndetit duhet t'i sfidojnë nxënësit dhe arsimtarët brenda një spektri të gjerë aktivitetesh fizike, akademike, sociale dhe të komunitetit.
- Shkollat promovuese të shëndetit duhet të sigurojnë një lidhje me prindërit a kujdestarët si dhe me shkollat e tjera e me bashkësinë, me anë të iniciativave lidhur me shëndetin.
- Shkollat promovuese të shëndetit duhet të përdorin në mënyrë të efektshme dhe të përshtatshme shërbimet që mund të realizohen me anë të këshillave, përkrahjeve, shërbimeve a kontributeve të tjera, e që do të rezultojnë me promovimin e shëndetit, sjellje pozitive dhe mësim të suksesshëm.

Vlerat themelore të një iniciative të shkollave promovuese të shëndetit, e cila bëhet edhe përmes partneritetit, mund të jenë respektimi i vetës, respektimi i ndryshimeve tek të tjerët, respekti për mjedisin, shfrytëzimi i tërësisë së ofertës që bëjnë shkolla si programe mësimore, familja dhe bashkësia me tërë spektrin e mundshëm të individëve, grupeve të interesit dhe institucioneve qeveritare e joqeveritare, të ndërlidhura me konceptin e shkollave promovuese të shëndetit. Në mjedise të tilla është e mundur që mësimi të bëhet proces i vazhdueshëm dhe në vazhdimësi për tërë jetën.

Kjo do të mundësojë që secili person të kontribuojë në familje dhe bashkësi, duke zbatuar dhe jetësuar në praktikë shkathtësitë e mësuara, gjatë jetës.

1.4.2. Koncepti i shkollave "Mike për Fëmijët" i zhvilluar nga UNICEF-i

Brenda kornizës së përgjithshme të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës dhe të Konventës mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj femrave, programi synon të kontribuojë në garantimin se të gjitha të drejtat e fëmijëve respektohen dhe monitorohen.

Objektivat kryesorë të programit janë:

- a) të përmirësojë shërbimet shoqërore dhe të fuqizojë familjet me njohuri e shkathtësi për t'u krijuar mundësi që të sigurohen se foshnjat dhe

fëmijët janë të shëndoshë, emocionalisht të sigurt dhe në gjendje që të nxënë në një ambient të sigurt;

- b) të kontribuojë në qasjen universale të arsimit cilësor formal dhe joformal dhe të zvogëlojë përqindjen e braktisjes së shkollimit, veçanërisht të vajzave dhe fëmijëve të minoriteteve;
- c) të pajisë fëmijët me shkathtësi të nevojshme për t'u bërë të shëndetshëm, aktivë dhe qytetarë të përgjegjshëm;
- d) të kontribuojë në përmirësimin e politikave dhe legjislacionit për fëmijët që kanë nevojë për mbrojtje të veçantë, dhe prezantimin e alternativave me bazën në familje.

Koncepti i shkollave "Mike për Fëmijët" është bazuar në këtë politikë dhe ka pasur për qëllim të lehtësojë zhvillimin e qasjeve specifike vendore ndaj proceseve të përmirësimit të shkollave. Shkolla "Mike për Fëmijët" është definuar si shkollë e shëndoshë, e efektshme e mbrojtëse, në të cilën janë përfshirë në mënyrë aktive familja dhe komuniteti.

1.5. Shkollat promovuese në kontekstin e sotëm

1.5.1. Konteksti politiko-shoqëror

Fillimi i hartimit të strategjisë është i lidhur ngushtë edhe me situatën kur Kosova u gjend në një vakuum të statusit politik të saj. Në këtë situatë, Kosova duhet të plotësojë shumë standarde të përcaktuara nga Bashkësia Ndërkombëtare, standarde të cilat prekin edhe fushat e arsimit, shëndetësisë, mjedisit. Për sa i përket kësaj, duhet cekur se nuk ka një sistem unik në të tri sferat e përmendura, duke theksuar se udhëheqja momentale e këtyre sektorëve varet edhe nga ndikime politike. Më konkretisht, një pjesë e saj koordinohet nga strukturat e Qeverisë së Kosovës dhe, nga ana tjetër, strukturat paralele, që kanë ndikim nga Serbia.

Një mospërcaktim përfundimtar i politikave, që do të zbatohen në këto tri sfera, ka lënë një zbrazëti dhe amulli edhe tek politikëbërësit dhe vendimmarrësit se në cilën anë do të shkojnë orientimet strategjike të ardhshme. Më hollësisht, kjo nënkupton çështjen se a do të jenë këto tri fusha të jetës të rëndësishme për qeveritë e ardhshme, gjegjësisht a do të kenë prioritet ato në aspektin financiar. Së dyti, ka tendenca të fuqishme për

një privatizim të edukimit dhe përkujdesjes për shëndetin, dhe kjo do të ndikonte po ashtu në lëvizjet për sa i përket prioritetit financiar nga ana e Qeverisë në të ardhmen përkitazi me qëndrimin ndaj shkollave promovuese të shëndetit. Mjetet e caktuara nga BK për sektorin e arsimit, mjedisit dhe shëndetit, janë të pamjaftueshme sepse burim i buxhetit është prodhimtaria e vogël, dhe vetë mënyra e kufizuar e grumbullimit të mjeteve në buxhet nuk siguron një qëndrueshmëri të financimit afatgjatë dhe premtues.

Të gjitha këto e pamundësojnë që arsimi, shëndetësia dhe mjedisi, po edhe faktorë të tjerë që ndikojnë tek nxënësi, pedagogu, familja dhe bashkësia, të shihen si fusha të ndara në raport me ngjarjet dinamike në rrethin e integriteteve evropiane dhe ndërrimeve përcjellëse, që ngjajnë në vende evropiane. Pikërisht këtu duhet ndikuar sa më shpejt, nëse mendohet t'u bashkohemi proceseve integruese.

Qëllimi dhe objektivat e ShPSH-së janë si vijon:

- Arritja e një mënyre të shëndetshme të jetesës për tërë popullatën e shkollës dhe komunitetin në tërësi
- Krijimi i një ambienti të shëndetshëm dhe stimulues për të mësuar dhe për mësimdhënie
- Ndërtimi i shkathtësive individuale
- Fuqizimi i bashkëpunimit në mes shkollës dhe komunitetit
- Fuqizimi i bashkëpunimit ndërmjet sektorëve të ndryshëm, si arsimi, shëndetësia, mjedisi etj.
- Zhvillimi i rregulloreve e strukturave dhe zbatimi i praktikave që mbështetin shëndetin brenda dhe jashtë shkollës

1.5.2. Parimet themelore të shkollave promovuese të shëndetit në kontekstin kosovar

Parimet evropiane për shkollat promovuese të shëndetit, që nga viti 1996 janë dhënë si prioritete, pikërisht: demokracia, barazia, fuqizimi, gara në aktivitete, mjedisi shkollor, kurrikulet, trajnimi i personelit arsimor, matja e suksesit të bashkëpunimit, bashkësia dhe qëndrueshmëria. Në disa modele të zhvillimit brenda Evropës janë adaptuar parimet themele në ato vendore, që, si në Skoci, përfshijnë edhe veprimtarinë në formë partneriteti, krijimin e karaktereve pozitive, përmirësime mjedisi, punë më të ndërlidhur me familjet

dhe prindërit, sigurimin e një bashkërendimi të efektshëm, përmirësimin dhe zgjerimin e kurrikuleve, konsideratat për shëndetin dhe mirëqenien e personelit.

Parimet mbi të cilat bazohet strategjia e shkollave promovuese të shëndetit në Kosovë, janë ato mbi të cilat bazohet edhe sistemi i arsimit, duke u shtuar parimet bazë të shëndetësisë, parimet themelore që kanë të bëjnë me mjedisin dhe ndikimin e tij në arsimin dhe shëndetin. Parimet mbi të cilat bazohet sistemi i arsimit, janë:

- Zhvillimi i personalitetit , talentit dhe potencialit të plotë të aftësive mendore e fizike të nxënësit,
- respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të shpallura me kartën e Kombeve të Bashkuara dhe në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut,
- zhvillimi i ndjenjës së respektit për prindërit dhe mësuesit, për identitetin kulturor, gjuhën dhe vlerat e Kombit dhe vlerat e komuniteteve si dhe qytetërimet e tjera, që janë të ndryshme nga qytetërimi i tij,
- zhvillimi i ndjenjës së respektit për mjedisin si dhe përgatitja e nxënësit për një jetë të përgjegjshme në një shoqëri të lirë, në frymën e mirëkuptimit, tolerancës, barazisë gjinore dhe miqësisë midis gjithë popujve, grupeve etnike, kombëtare e fetare si dhe personave me origjinë nga i njëjti vend.

Duke u bazuar në Ligjin mbi arsimin fillor e të mesëm, regjistrimi dhe përparimi nëpër të gjitha nivelet e arsimit fillor e të mesëm në Kosovë, mundësohet pa asnjë lloj diskriminimi të drejtpërdrejtë ose jo të tërthortë për arsye reale a të supozuara, që kanë lidhje me gjininë, racën, prirjet seksuale, të metat fizike e intelektuale ose handikepe të tjera, gjendjen civile, ngjyrën, religjionin, opinionet politike a të tjera, origjinën kombëtare, etnike a sociale, përkatësinë ndaj një komuniteti kombëtar, pronësinë, vendlindjen apo rrethanat e tjera të nxënësit ose familjes së tij.

Nga aspekti i sistemit shëndetësor, parimet themelore kryesore janë: barazia, cilësia, ndershmëria dhe përgjegjësia, gjithëpërfshirja dhe jo diskriminimi, trajtimi korrekt i qytetarëve bazuar në ligjin. Shëndetësia ka po ashtu parim edhe respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të

përcaktuara me Konventa Ndërkombëtare, sigurimin e qasjes së plotë të kujdesit shëndetësor në të gjitha nivelet dhe për të gjithë qytetarët, duke siguruar, për personat me aftësi të kufizuara, një qasje të lehtë fizike në institucione. Gjatë zbatimit të kujdesit shëndetësor, institucionet dhe personeli shëndetësor përkujdeset që kjo të realizohet me aplikimin e standardeve ndërkombëtare, etike dhe duke mbrojtur interesat e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore. Gjithëpërfshirja dhe jo diskriminimi sigurohen me një përkujdesje shëndetësore të barabartë për të gjithë qytetarët, duke siguruar standardet për përmbushjen e kërkesave në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, si dhe sigurimin e përkujdesjes shëndetësore pa diskriminim mbi bazë të gjinisë, kombit, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, bindjeve politike, gjendjes sociale, statusit pronësor, shkallës së aftësive fizike e mendore, statusit familjar dhe moshës.

Nga Strategjia shëndetësore e Kosovës, 2005-2015, e nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë, ndër shumë synime të tjera janë përcaktuar edhe zvogëlimi i mortalitetit e morbiditetit si dhe përmirësimi i rritjes dhe zhvillimit psikofizik, përmirësimi i shëndetit riprodhues ngritja e shkallës së imunizimit, përmirësimi i shëndetit të të rinjve, pakësimi i pirjes së duhanit, me theks të veçantë tek të rinjtë. Parandalimi nga varësia ndaj drogës dhe i sjelljeve të rrezikshme, me theks të veçantë në popullsinë e moshës së re. Të përmirësohet shëndeti mendor i të rriturve, fëmijëve dhe adoleshentëve duke zhvilluar shërbimet e shëndetit mendor të bazuar në komunitet. Të ndikohet në zvogëlimin deri tek eliminimi i shkallës së incidencës së vetëvrasjeve dhe tentimvetëvrasjeve. Të zvogëlohet numri i sëmundjeve ngjitëse dhe jo ngjitëse, me theks të veçantë mbi TBC-në dhe HIV/AIDS-in. Të përmirësohet shëndeti oral. T'u jepet prioritet programeve parandaluese dhe, me qëllim zvogëlimin e pabarazive në statusin shëndetësor. Të bëhen programe dhe të përkrahët përmirësimi i të ushqyerit. Të inkurajohet shtimi i nivelit të aktiviteteve fizike dhe zhvillimi i ambientit të shëndoshë fizik. Të reduktohet numri i aksidenteve në trafik dhe të sigurohen shërbime shëndetësore të arritshme dhe të përshtatshme për të gjitha nivelet socio-ekonomike dhe grupet etnike.

Parimet themelore të edukimit mjedisor dhe ndikimi i tij në arsimin dhe shëndetin, janë këto si vijojnë: Parimi i edukimit mjedisor, i bazuar në zhvillimin e qëndrueshëm; Parimi i ndërgjegjësimit dhe i pjesëmarrjes në vendimmarrje; Parimi i integritetit të çështjeve mjedisore në programet mësimore dhe harmonizimi i tyre me përmbajtjet e tjera; Parimi i kujdesit dhe

parandalimit të veprimeve negative në mjedis; Parimi i përgjegjësisë individuale ndaj veprimeve në mjedis; Parimi i qëndrimit aktiv ndaj veprimeve negative në mjedis; Parimi i përkujdesjes për vlerat mjedisore/natyrore; Parimi i aftësisë të vazhdueshëm të stafit mësimor në lëmin e edukimit mjedisor; Parimi i bashkëveprimit reciprok ndaj dukurive negative ndaj mjedisit.

1.5.3. Arritjet në fushën e shkollave promovuese të shëndetit në Kosovë pas vitit 1999

Nga viti 1999, pas përfundimit të luftës, në Kosovë menjëherë filluan të bëheshin intervenime fizike në infrastrukturën e institucioneve arsimore në të gjitha nivelet arsimore, për t'u krijuar kushte elementare për vazhdimin e procesit të edukimit. Po ashtu, filluan edhe ndërrimet në përmirësimin e shkathtësive të trupit arsimor dhe përkrahës, me qëllim të ngritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Shumë ekspertë ndërkombëtarë dhe vendorë brenda institucioneve qeveritare si dhe atyre joqeveritare, ishin pjesëmarrës aktivë, duke pasur një motivim të lartë në këto procese.

Situata kur pjesës së shkollimit në gjuhën shqipe i ishte dhënë një grusht i fortë institucional, sa kohë që në përgjithësi arsimit dhe shëndetësia kishin attribute të një sistemi të centralizuar, ku nxënësi nuk ishte në pozitën qendrore të vëmendjes, u bë shkas që të intensifikoheshin aktivitetet në të gjitha fushat me qëllim të ngritjes së kapaciteteve menaxhuese, edukuese, administrative të gjithë personelit të angazhuar në procesin arsimor.

UNICEF, si agjenci udhëheqëse për mbështetjen e arsimit kosovar në fazën e emergjencës, koordinoi riparimin dhe rehabilitimin e shkollave të shkatërruara gjatë konfliktit të fundit në Kosovë dhe, po ashtu, ndihmoi drejtpërdrejt në rindërtimin e 22 shkollave, të cilat ishin shkatërruar tërësisht, riparimin e nyjave sanitare në 92 shkolla, riparimin e 24 shkollave pilot 'Shkolla Mike për Fëmijët'. Në të njëjtën fazë, UNICEF-i furnizoi një numër të madh shkollash anembanë Kosovës me pajisje dhe material shkollor, si dhe u siguroi 34 4 WD vetura për nevojat e zyrtarëve të arsimit.

Projekti 'Shkollat Mike për Fëmijët' filloi të zbatohet në vitin 2000 përmes 7 partnerëve (CRS, Care International, Qendra për Arsimin e Kosovës, Prijatelji Dece, EducAId, World Vision, Forumi Kosovar i Grave) dhe kishte për qëllim përhapjen e risive dhe reformave të arsimit në nivel të shkollës, përmes promovimit të metodologjive të reja të mësimdhënies/nxënies dhe kurrikulit

të ri, aftësive për jetën, arsimin për tolerancë e paqe, pjesëmarrjen aktive të komunitetit në shkollë, qasjen inkluzive për t'u ballafaquar me dallimet, veçanërisht për fëmijët me nevoja të veçanta, fëmijët e minoriteteve, etj. Sot flasim për një numër prej rreth 150 shkollash, që përbëjnë një rrjet të madh të shkollave mike anembanë Kosovës, shkolla të cilat janë të hapura për risi dhe në gjendje të kontribuojnë në ngritjen e cilësisë së arsimit në Kosovë.

UNICEF ka kontribuar po ashtu edhe në ndërtimin e kapaciteteve institucionale, për të ndihmuar dhe forcuar sistemin e arsimit kosovar. Autoritetet qendrore, rajonale dhe komunale të arsimit janë përkrahur përmes ofrimit të asistencës teknike dhe pajisjeve. Përkrahje e madhe i është dhënë procesit të hartimit të Kornizës së re të kurrikulit të Kosovës si dhe kurrikuleve lëndore. Lënda 'Aftësitë për Jetën' është pilotuar për herë të parë si lëndë e zgjedhur në vitin shkollor 2005-2006 për nxënësit e klasës 8 në afro 100 shkolla të mesme të ulëta të Kosovës. Materia programore e kësaj lënde ka për qëllim ndryshimin e sjelljeve dhe përqendrohet në zhvillimin e aftësive, siç janë komunikimi, marrja e vendimeve, menaxhimi i ndjenjave, krijimi i vetëbesimit, etj. përmes metodologjisë ndëraktive. Përveç kësaj, kurrikuli adreson çështjet e rëndësishme, siç janë HIV/AIDS, sëmundjet që barten seksualisht,, shëndetin riprodhues, si dhe çështje të tjera të lidhura me shëndetin.

OBSH është duke përkrahur krijimin e një fryme të re në shkolla përmes konceptit të "Rrjetit Evropian të shkollave promovuese të shëndetit " dhe duke iniciuar këtë koncept në Kosovë, me një aktivitet të shtuar në Mitrovicë, me qëllim adresimin dhe parandalimin e helmimit me plumb.

OBSH-ja me qëllim të mbështetjes së institucioneve vendore në realizimin e programit të shkollave promovuese të shëndetit, ka organizuar një varg trajnimesh mbi konceptet, planifikimin dhe zhvillimin e shkollave promovuese të shëndetit. Pjesëmarrës në këto trajnime ishin zyrtarë të arsimit, shëndetësisë dhe mjedisit nga të gjitha nivelet administrative (qendror, rajonal dhe komunal) si dhe përfaqësues të shoqërisë civile, drejtorë të shkollave dhe arsimtarë. Në trajnime janë përfshirë edhe pjesëmarrësit e të njëjtëve sektorë të komunitetit serb. OBSH-ja ka mbështetur përkthimin e manualeve për trajnerë dhe mësimdhënës në lëmin e promovimit të shëndetit të të rinjve, duke shfrytëzuar qasjen e shkollave promovuese të shëndetit.

Me këtë trajnim, duke mbështetur realizimin e konceptit të shkollave promovuese të shëndetit, janë përfshirë 18 shkolla fillore në 3 komuna, me

më shumë se 90 arsimtarë, 18 drejtorë shkollash, 20 profesionistë shëndetësorë, 5 zyrtarë të lartë të arsimit, disa profesionistë dhe zyrtarë të lartë të mjedisit dhe përfaqësues të shoqërisë civile të të dy komuniteteve, si atij shqiptar ashtu edhe atij serb. Trajnimet u realizuan nga ekspertët e OBSh-së - Zyra Rajonale për Evropën.

Po ashtu, me qëllim të ndërtimit të kapaciteteve, OBSh ka organizuar vizita studimore në vende të tjera në Evropë, të cilat janë anëtare të rrjetit evropian të shkollave promovuese të shëndetit që nga viti 1993, si p.sh. në Slloveni, Poloni dhe Maqedoni.

Në të tri komunat janë formuar strukturat komunale, respektivisht ato rajonale të shkollave promovuese të shëndetit, me këtë strukturë:

- Komitet këshillëdhënëse të përbëra nga zyrtarë të arsimit, shëndetësisë, mjedisit dhe shoqërisë civile.
- Grupet për promovimin e shëndetit në shkollë, të përbëra nga arsimtarë, nxënës, prindër, personeli i mirëmbajtjes së shkollës dhe ai administrativ.
- Koordinator për promovim të shëndetit në nivel të shkollës.

Organizata Ndërkombëtare e Migrimit (IOM), gjatë viteve 2003 – 2004, ka zbatuar projektin e parandalimit dhe mbikëqyrjes së tuberkulozit dhe HIV/AIDS dhe për problemin e konsumimit të mjeteve narkotike, alkoolit e duhanit, përmes projektit pilot, për realizimin e të cilit janë angazhuar shkollat fillore të komunave të Prizrenit, Mitrovicës, Prishtinës dhe shkollat me mësim në gjuhën serbe të 2 fshatrave të Gjilanit.

Me këtë projekt janë realizuar trajnime të 70 pedagogëve lidhur me metodat dhe përmbajtjen e edukimit shëndetësor si dhe realizimi i 15 – 20 orëve të rregullta të edukimit shëndetësor në periudhën 6-mujore. Në disa shkolla si kërkesë imediate e këshillave të prindërve dhe vetë nxënësve, edukimi shëndetësor është bërë lëndë e zgjedhur.

Edhe shumë institucione, si Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë publike të Kosovës, Qendrat e mjekësisë familjare, Shërbimi Policor i Kosovës, OJQ, shoqatat e ndryshme, përfshirë edhe disa qendra rinore, veprimtaritë e veta i kanë zhvilluar rregullisht në hapësirat shkollore, duke përhapur njohuri e duke zhvilluar aktivitete lidhur me shëndetin dhe mjedisin. Po ashtu, nuk janë lënë pas dore as çështje

aktuale me rëndësi për fëmijët dhe bashkësinë, si imunizimi, asanimi i mjedisit e të ngjashme.

Në programin lëndor të Kosovës dhe në programet lëndore për të gjitha klasat dhe moshat e fëmijëve, edukimi shëndetësor mund të trajtohet si lëndë e zgjedhur. Shkolla, sipas zgjedhjes së nxënësve, vendos se cilat nga temat në kuadër të edukimit shëndetësor rekomandohen të zgjidhen dhe të mësohen. Kjo mund të bëhet si lëndë a kurs i zgjedhur nga nxënësit, nëse për këtë deklarohen së paku 15 nxënës. Edukimi shëndetësor në materien programore të lëndëve tjera trajtohet si pjesë ndërprogramore.

Gjeneratat e tanishme dhe gjeneratat e ardhshme edukohen për të gëzuar të drejtën për një ambient të sigurt dhe të shëndetshëm. Temat e shtjelluara në fushën e edukimit shëndetësor i aftësojnë nxënësit të kuptojnë natyrën e rrezikut në situata të ndryshme, pastaj si të identifikojnë ambientet e rrezikshme si dhe prej kujt të kërkojnë ndihmë në rast aksidenti ose sëmundjeje. Në këtë mënyrë, nxënësit edukohen dhe aftësohen për të parandaluar, duke evituar intervenimet eventuale dhe shërimin e panevojshëm dhe të shtrenjtë.

Temat e veçanta në fushën e edukimit shëndetësor duhet të ngërthejnë çështjet në vijim:

- Vetëdijësimi për rrezikun e përdorimit të duhanit, alkoolit dhe drogës;
- Mbrojtja nga HIV/AIDS-i dhe sëmundjet e tjera, që barten me rrugë seksuale;
- Edukimi seksual dhe shëndeti riprodhues;
- Mbrojtja kundër keqtrajtimeve dhe dhunës seksuale;
- Të ushqyerit e shëndetshëm dhe roli i aktiviteteve sportive ;
- Edukimi mbi vetëdijësimin për minat

Po ashtu, edhe Departamenti i Rinisë (DR) i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është zotuar për të kontribuar aktivisht lidhur me ngritjen e cilësisë dhe aktiviteteve brenda shkollave dhe jashtë tyre, për të ndikuar kështu në komunitetin, që është rreth shkollës. Një prej politikave programore të MKRS/Departamenti i Rinisë, është edukimi dhe promovimi shëndetësor. Qysh nga themelimi, në kuadër të këtij programi janë përkrahur shumë organizata dhe qendra të të rinjve në zbatimin e projekteve, që promovojnë mbrojtjen

dhe ruajtjen e shëndetit të rinisë. DiR gjithnjë ka synuar që në projektet e tij, ose të financuara prej tij, të përfshijë të rinjtë që janë jashtë shkollave, në projektet e tij. Megjithatë, vetë qasja më e lehtë ndaj të rinjve që janë në shkolla, ka bërë që shumica e projekteve të zbatohen në shkolla. Kjo ka edhe anën e vet pozitive, siç është lidhja e shkollës me bashkësinë. Përveç kësaj, një prej sukseseve të mëdha të zbatimit të programit të DiR/Sektorit i edukimit dhe promovimit, është edhe mundësia që u jepet të rinjve, që të identifikojnë nevojat, të planifikojnë projektet, t'i zbatojnë ato dhe të menaxhojnë fondet, përfshirë këtu edhe përvojën praktike që arrijnë ata. Gjithashtu MKRS/DR ka themeluar një qendër këshillimi e informacionesh të të rinjve, që quhet **"...dëgjo rininë"**, e që në njëfarë mënyre është një lloj i shërbimeve shëndetësore mike për të rinjtë.

Sipas raportit të kësaj qendre, për dy vjet të ekzistimit të saj, në qendër kanë kërkuar shërbime të ndryshme 1527 të rinj. Qendra ka prodhuar 24 filma metrazhi të shkurtër, me porosi edukuese kundër substancave që shkaktojnë vartësi dhe nga një film dokumentar të shkurtër ku janë trajtuar çështja e duhanit dhe ajo e HIV/AIDS. Këta filma janë një burim i dobishëm i informatave që mund të përdoren me qëllim të promovimit dhe ruajtjes së shëndetit.

Në vitin 2004 MKRS/DR ka financuar një projekt me titullin "Hulumtimi cilësor dhe sasior i njohurive, qëndrimeve dhe shprehive të të rinjve për shëndetin seksual dhe riprodhues". Në hulumtim kanë marrë pjesë 900 të rinj dhe 13 grupe fokus me 122 pjesëmarrës. Në bazë të të dhënave të hulumtimit, njohuritë e të rinjve janë të mangëta dhe duhet të punohet më shumë, si në hartimin e materialeve edukuese, ashtu edhe në ngritjen e cilësisë së materies programore të edukimit shëndetësor si lëndë mësimore alternative.

Përveç kësaj, në bashkëpunim me UNFPA, për dy vjet është bërë ngritja e kapaciteteve të të rinjve në Komunat e Fushë-Kosovës dhe Lypjanit lidhur me shëndetin riprodhues të të rinjve, duke përfshirë kryesisht grupet e rinisë të minoritetit REA. Nga ky projekt janë krijuar 55 të rinj 'peer educator'.

2. VIZIONI

Një sistem efikas, brenda burimeve me të cilat disponohet, i cili siguron mjedis shkollor të hapur dhe nxitës për pjesëmarrje aktive, ku secili e ndien veten të sigurt, të barabartë e të lumtur, mjedis i cili do të jetë i gatshëm për adoptimin e standardeve të pranuar ndërkombëtare.

3. MISIONI

Me qëllim të realizimit të vizionit që kemi përcaktuar më përpara, është përcaktuar misioni i strategjisë së shkollave promovuese të shëndetit, që është:

Sigurimi i një mjedisi shkollor të shëndetshëm dhe miqësor përmes edukimit shëndetësor, promovimit të mbrojtjes së mjedisit dhe forcimit të partneritetit ndërmjet shkollës, prindërve dhe komunitetit.

Për të realizuar misionin tonë, duhet të jetësohen edhe mekanizmat përkatës të parashikuar brenda fushave, si ajo e arsimit, mjedisit, shëndetësisë, ekonomisë dhe të një mjedisi të përshtatshëm përkrahës politiko-administrativ. Çështja e zbatimit me konsekuencë të misionit do të ndiqet me vëmendje përmes masave, që do të prodhojnë zvogëlimin e incidencës së sëmundjeve ngjitëse dhe çrregullimeve zhvillimore psikofizike tek nxënësit. Po ashtu, edhe zvogëlimi i rasteve të dhunës në shkolla do të jetë tregues i zbatimit të suksesshëm të Strategjisë dhe misionit të saj.

4. OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

Gjatë punës së organizuar në punëtorinë, e cila kishte për qëllim të ndihmonte në procesin e përpilimit të strategjisë së shkollave promovuese të shëndetit, grupet e ekspertëve të fushave të ndryshme kanë identifikuar 6 objektiva strategjike, të cilët duhet të arrihen në periudhën e paraparë. Këta objektiva janë:

- 4.1. Mjedis i shëndetshëm dhe përkrahës nga ana e mësimitdhënësve, nxënësve dhe prindërve**
- 4.2. Mjedis fizik i përshtatshëm dhe i shëndetshëm për mësimitdhënie dhe të nxënë (mbështetur në udhëzimet e strategjisë për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë 2007-2018)**
- 4.3. Kapacitete të mjaftueshme njerëzore dhe materiale**
- 4.4. Përkujdesje cilësore dhe e vazhdueshme për shëndetin e nxënësve**
- 4.5. Shkallë e ulët e dhunës në shkollë**
- 4.6. Nivel i kënaqshëm i kulturës shëndetësore dhe mjedisore tek nxënësit**

Në mënyrë që realizimi i objektivave të ndiqet me vëmendje dhe të verifikohet, janë përcaktuar edhe treguesit përkatës. Po ashtu, për të arritur objektivat e përcaktuar, janë saktësuar edhe aktivitetet e nevojshme, përmes të cilave do të realizohet edhe strategjia e shkollave promovuese të shëndetit. Praktikisht, aktivitetet e përcaktuara mund të konsiderohen edhe si projekte të veçanta në zhvillimet e mëtejme të zbatimit të strategjisë.

4.1. Mjedis i shëndetshëm dhe përkrahës nga ana e mësimitdhënësve, nxënësve dhe prindërve

Të gjithë pjesëmarrësit në procesin e krijimit të një mjedisi përkrahës për zbatimin e strategjisë së shkollave promovuese të shëndetit, duhet të bëjnë transformime drejt ngritjes së shkallës së informimit të tyre, që të kenë njohuri të mjaftueshme lidhur me faktin se ç'ofron një mjedis shkollor. Një mjedis i atillë që si detyrë ka të përqafojë dhe të inkuadrojë të gjithë pjesëmarrësit në procesin e arsimit, me qëllim të ngritjes së cilësisë së

mësimi, po njëkohësisht edhe të zvogëlimit të incidencës së sëmundjeve ngjitëse e çrregullimeve zhvillimore psikofizike tek nxënësit si dhe ngritjes së shkallës së sigurisë fizike, duke pakësuar rastet e ofendimeve, kërcënimeve dhe llojeve të tjera të dhunës në shkolla.

Për të ndjekur zbatimin e një koncepti të tillë, janë përcaktuar edhe:

TREGUESIT

1. Të paktën 90 % e shkollave, marrin pjesë çdo vit në javën e pastrimit.
2. Të paktën 20% e shkollave gjatë një viti marrin pjesë në aktivitete vetëdijesimi.
3. Deri në vitin 2018, të paktën 50 % e shkollave do të realizojnë projekte për mjedisin.
4. Deri në vitin 2018, 90% e shkollave do të kenë formuar grupe ekologjike.

MASAT

Masa 4.1.1. Fushata vetëdijesimi për mjedisin dhe shëndetin

Përshkrimi

- Informimi i prindërve për ndikimin e mjedisit në gjendjen shëndetësore të pjesëmarrësve në procesin e arsimit në takimet e prindërve, dhe inkurajimi i tyre për punë të përbashkët në çështje lidhur me shëndetin
- Bashkimi në aktivitete të përbashkëta në shkolla me pjesëmarrjen vetjake në aktivitete të mirëmbajtjes së rregullt të mjedisit dhe përparimit e ruajtjes së shëndetit

SUPOZIMET KRITIKE

Realizimi i një mase të tillë duhet të sigurojë patjetër pjesëmarrjen aktive të prindërve dhe bashkësisë, me qëllim të zhvillimit të partneritetit dhe ndjenjës së pronësisë ndaj mjedisit shkollor. Po ashtu, prindërit dhe bashkësia duhet të përkrahin edhe aktivitete të natyrës financiare, kur, të vetëdijesuar për këto, të shohin kontributin e drejtpërdrejtë për shëndetin e fëmijëve dhe përfitimet në ngritjen e sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në proces.

Masa 4.1.2. Hartimi i programeve dhe materialeve për shëndetin dhe mjedisin shkollor

Përshkrimi

- Rishikimi i planeve dhe programeve ekzistuese brenda shkollave, si i aftësive për jetë, edukimit shëndetësor dhe mjedisor, me theks të veçantë në pjesën praktike të punës në mjediset shkollore, me qëllim të ruajtjes, avancimit dhe përmirësimit të mjedisit shkollor, me synimin që këto të jenë si pjesë ndërkurrikulare apo si lëndë të veçanta
- Hartimi i kurrikuleve të reja të bazuara në koncepte të shkollave promovuese të shëndetit, të cilat do të përmirësojnë njohuritë e nxënësve për faktorët që ndikojnë në shëndetin dhe i aftëson ata që të bëjnë zgjedhjen e shëndoshë dhe të adaptojnë sjelljet e shëndetshme gjatë tërë jetës së tyre; Materie programore që përfshin shkathtësi kritike për shëndetin dhe jetën, me qëllim promovimin e shëndetit dhe mirëqenies si dhe parandalimin e problemeve të rëndësishme shëndetësore, informata dhe aktivitete, të cilat u përgjigjen aftësive intelektuale dhe emocionale të fëmijëve
- Hartimi i materialeve të përshtatshme për nivele të ndryshme me pjesëmarrje të përfituesve dhe trajnimi i
 - nxënësve,
 - personelit në arsim, dhe
 - prindërve

me qëllim të ngritjes së njohurive lidhur me mjedisin dhe shëndetin, duke mundësuar dhe inkurajuar pjesëmarrje të ekspertëve për fushat e mjedisit e shëndetësisë, dhe ekspertë të tjerë në rolin e këshilltarëve gjatë përpilimit dhe realizimit të këtyre materialeve

- Pilotimi i materialeve
- Shumëzimi dhe shpërndarja në tërë rrjetin e shkollave e, përmes tyre, edhe në bashkësi

- Formimi i shoqatave ekologjike ndërshkollore, me qëllim të avancimit dhe përcjelljes së programeve dhe rrjetëzimi i shkollave që kanë programe të ngjashme e stimulimi i krijimit të programeve në shkollat që nuk kanë programe të tilla.

Masa 4.1.3. Trajnime të punonjësve të arsimit për qasjen e SHPSH

Përshkrimi

- Informimi i punonjësve të arsimit lidhur me hartimin e formave për organizimin e aktiviteteve të ndryshme në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit të shëndetshëm shkollor, në mbledhje të organizuara nga strukturat udhëheqëse të shkollës
- Krijimi i kushteve të përshtatshme për vijimin e trajnimeve
- Organizimi i trajnimeve për punonjësit e arsimit
- Mbajtja e trajnimeve në hapësirat shkollore apo afër vendbanimit të punonjësve të arsimit
- Stimulimi për vijimin e trajnimeve dhe zbatimin e aktiviteteve lidhur me shkollat promovuese të shëndetit
- Licencimi për edukimin dhe aftësimin e vazhdueshëm të mësimitdhënësve që përkrahin konceptin e shkollave promovuese të shëndetit
- Ndërtimi i kapaciteteve për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e përparimit të vazhdueshëm të punonjësve të arsimit
- Ndjekja e vazhdueshme e zbatimit të njohurive të fituara, përmes mbikëqyrjes dhe vlerësimit.

SUPOZIMET KRITIKE

Me qëllim të vijimit të rregullt dhe zbatimit të masës së paraparë, nevojitet patjetër një interesim i shprehur nga ana e punonjësve të arsimit. Për t'u realizuar një gjë e tillë, pjesëmarrësit duhet të identifikojnë dobitë personale, familjare dhe kolektive të tërë bashkësisë, dhe njëkohësisht për pjesëmarrësit të sigurohet një mënyrë shpërblimi apo stimulimi

4.2. Mjedis fizik i përshtatshëm dhe i shëndetshëm për mësimdhënie dhe të nxënë (mbështetur në udhëzimet e strategjisë për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë 2007-2018)

Ambienti ku zhvillohet procesi mësimor, është hapësira ku pjesëmarrësit, përveç mësimnxënies, duhet të kenë edhe mundësi për të siguruar procese të rëndësishme për zhvillimin e tyre normal psikofizik e shëndetësor, për lirinë e komunikimin dhe lëvizjes. Kjo do të thotë siguri fizike të pjesëtarëve në këtë proces, si dhe socializim i drejtpërdrejtë i tyre përmes zhvillimit të aktiviteteve, që do të përkrahin një gjë të tillë, dhe kontakteve në mes të pjesëmarrësve.

Mjedisi fizik i të nxënit është një ndër karakteristikat kryesore të shkollës efektive. Studime të shumta flasin për ndërlidhje organike të mjedisit fizik cilësor me parametrat e tjerë të efektivitetit, siç janë: udhëheqja profesionale, pritshmëritë e larta, shndërrimi i shkollës në organizatë të të nxënit, etj. Në kushtet e Kosovës, përmbushja e këtij objekti është mjaft sfiduese, sepse kërkon guxim dhe përkushtim të lartë të politikëbërësve, për të bërë investime të mëdha financiare që nuk mund të shpaguhen brenda një afati të shkurtër.

Me qëllim të përmirësimit dhe avancimit të mjedisit shkollor për sa i përket infrastrukturës, janë bërë përpjekje si nga ana e Qeverisë së Kosovës, ashtu edhe nga donatorë, të cilat në një mënyrë kanë zbutur problemin akut të mungesës së hapësirave arsimore adekuate. Megjithatë, në një pjesë të shkollave procesi mësimor zhvillohet ende me pengesa të konsiderueshme pikërisht për shkak të infrastrukturës joadekuate. Në disa shkolla, me gjithë renovimet që janë bërë, nuk kanë mundur të sigurohen në tërësi standardet e rekomanduara për objektet shkollore, për shkak të mungesës së kushteve elementare higjienike dhe sanitare, në rend të parë të mungesës së ujit të pijshëm të sigurt, për pjesëmarrësit e procesit mësimor.

Numri i madh i fëmijëve në shkollat e padisenjuara për një ngarkesë të tillë, kushtëzojnë që procesi mësimor të zhvillohet edhe në disa ndërresa, që i shtyn pjesëmarrësit të fillojnë dhe të mbarojnë orarin e punës, respektivisht të zhvillojnë procesin mësimor edhe në kohë jo të përshtatshme dhe jo fiziologjike për moshën e shumicës së nxënësve. Për të ndjekur zbatimin e ndërhyrjeve që do të realizohen në fushën e përmirësimit dhe rregullimit të infrastrukturës së hapësirave të objekteve shkollore, janë përcaktuar edhe:

TREGUESIT

1. Deri në vitin 2018 mësimi të zhvillohet në më së shumti dy ndërresa;
2. Deri në vitin 2018 të arrihet sigurimi i infrastrukturës bazë të nevojshme në të gjitha shkollat;
3. Deri në vitin 2018 të sigurohen pajisjet bazë të teknologjisë ndihmëse për nxënësit me nevoja të veçanta;
4. Deri në vitin 2018 të sigurohen kushte themelore për realizimin e mësimi praktik për të gjitha shkollat profesionale (brenda shkollës ose në bashkëpunim me ekonominë);
5. Deri në vitin 2018 të krijohen kushte për aktivitete fizike dhe sportive në të gjitha shkollat;
6. Të gjitha shkollat të pajisen me mjete konkretizimi sipas standardeve.

MASAT

Masa 4.2.1. Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese shkollore

- Përshkrimi:**
- E gjithë infrastruktura e objekteve ekzistuese, në përputhje me normativat e përcaktuar duhet të plotësohet dhe të përmirësohet, në mënyrë që të ecet drejt realizimit të standardeve evropiane - EUROCODE.
 - Të gjitha hapësirat shkollore që nuk i plotësojnë standardet dhe që nuk janë në gjendje të mirë, duhet të rinovohen, duke përfshirë:
 - Rregullimin dhe përmirësimin i godinave shkollore
 - Rregullimin dhe përmirësimin e infrastrukturës për ujësjellës dhe kanalizim, ngrohje, telefon, internet
 - Rregullimin e hapësirave të jashtme si: terrenet sportive, oborret, gjelbërimi, kopshti dhe sheshet

Masa 4.2.2. Monitorimi i hapësirave të reja rekreative shkollore

Përshkrimi:

- Avokim për rritjen a hapësirave të gjelbëruara, terreneve sportive dhe sallave për edukatë fizike Sigurimi i mjedisit të sigurt për zbatimin e edukatës fizike dhe rekreacionit në mënyre të lirshme dhe pa ngacmime. Institucionet qeveritare qendrore dhe lokale, në bashkëpunim me partnerët, përqendrojnë përpjekjet e veta në ndërtimin e objekteve të reja shkollore në zonat ku punohet në më shumë se dy ndërresa dhe në zonat ku objektet shkollore paraqesin rrezik për sigurinë e nxënësve. Të gjitha investimet do të bëhen në pajtim me standardet dhe udhëzimet e miratuara.

Masa 4.2.3. Sigurimi i mirëmbajtjes dhe ruajtja e pasurisë shkollore

Përshkrimi:

- MASHT, në bashkërenditje me komunat, do të punojë në hartimin e politikave dhe në vendosjen e sistemit të menaxhimit dhe të mirëmbajtjes së pasurisë shkollore;
- Komunat dhe shkollat do t'i menaxhojnë dhe do të kujdesen për ruajtjen e objekteve dhe të hapësirës shkollore, si dhe për mirëmbajtjen dhe sigurinë e tyre, në përputhje me politikat e miratuara.

Masa 4.2.4. Pajisja e shkollave me mjete mësimore që sigurojnë ruajtjen e shëndetit

Përshkrimi:

- MASHT dhe komunat, në bashkëpunim me donatorë dhe partnerë, do të investojnë në furnizimin e shkollave me inventar dhe mjete mësimore standarde, si dhe me pajisje laboratorike të nevojshme. Kujdes i veçantë do t'i kushtohet përdorimit të teknologjive të reja në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.
- Blerja dhe organizimi i koncentruar i punëtorive dhe pajisjeve për arsimin profesional. Punëtoritë dhe pajisjet e tilla mund të shfrytëzohen edhe nga shkolla të tjera.
- Do të vendoset një bashkëpunim me qendrat për aftësimin profesional dhe me ndërmarrje ekonomike, me qëllim të shfrytëzimit të mjeteve të konkretizimit dhe të pajisjeve përkatëse për qëllime arsimore.

SUPOZIMET KRITIKE

Një dukuri tipike për infrastrukturën shkollore në Kosovë është mbingarkesa e kapaciteteve në zonat urbane, dhe shfrytëzimi relativisht i ulët i tyre në zonat rurale. Prandaj, perspektiva e përmirësimit të infrastrukturës është e lidhur ngushtë me dy supozimet vijuese, që janë jashtë kontrollit të zbatuesve të kësaj strategjie:

1. Stabilizimi i proceseve migruese dhe
2. Zhvillimi i viseve rurale.

4.3. Kapacitete të mjaftueshme njerëzore dhe materiale

Sigurimi i kapaciteteve të mjaftueshme njerëzore dhe materiale është premisë shumë e rëndësishme për të pasur shkolla cilësore promovuese të shëndetit. Plotësimi i kësaj premise do të siguronte një personel më të madh në shërbim të shëndetit të nxënësve, do të bënte të mundur sigurimin e infrastrukturës së plotë për një shëndet të mirë, si dhe do të sillte mirëmbajtje më të mirë të kësaj infrastrukture, sidomos të asaj sanitare, duke parandaluar kështu problemet shëndetësore. Sidoqoftë, realizimi i këtij objektivi strategjik varet shumë nga vëmendja që do t'i kushtohet atij nga buxheti i Kosovës.

TREGUESIT:

1. Deri në vitin 2018 të gjithë mësimmësuesit të kenë kaluar të paktën një trajnim për shëndetin
2. Deri në vitin 2018 Buxheti i Kosovës të caktojë mjete të mjaftueshme për shkollat e shëndetshme

MASAT

Masa 4.3.1. Aftësimi i personelit arsimor për promovim të shëndetit

- Përshkrimi**
- Personeli kualifikohet para shërbimit dhe gjatë shërbimit për zbatimin e aktiviteteve shëndetësore promovuese dhe edukuese
 - Aftësimi dhe trajnimi i vazhdueshëm i pjesëmarrësve në arsim: i punonjësve të arsimit, nxënësve dhe komunitetit, për avancimin e shëndetit dhe sigurisë në shkollë, që do të çojë drejt aftësimit për jetë, edukimit shëndetësor dhe edukimit mjedisor, bazuar në programet e aprovuara dhe të adaptuara për moshë specifike dhe për nevoja të veçanta.
 - Nxitja dhe organizimi nga nxënësit, të mbështetura edhe nga punonjësit e arsimit dhe komuniteti, - i aktiviteteve për shëndetin në shkollat përkatëse, sidomos përmes aktiviteteve të lira
 - Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve shtesë për mësimdhënësit dhe nxënësit
 - Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta në/me komunitet/in lidhur me shëndetin
 - Krijimi i mekanizmave monitorues dhe vlerësues për implementimin e aftësive të fituara
 - Krijimi i strukturave ndërsektorale për promovimin e shëndetit në shkollë: në nivel të shkollës, si:
 - emërimi i koordinatorit për promovimin e shëndetit në shkollë,
 - emërimi i grupit për promovimin e shëndetit (arsimtarë, nxënës, prindër, mirëmbajtës, administratorë shkolle, etj.) në nivel komunal,
 - Emërimi i komitetit këshillëdhënës, përbërë nga zyrtarë të arsimit, shëndetësisë, mjedisit, prindër,
 - Krijimi i planit zhvillimor për promovimin shëndetësor, mjedisor, social, për promovimin e sigurisë dhe barazisë në

nivel shkolle, - me pjesëmarrjen aktive të shkollës (nxënësve, arsimtarëve, administratorëve, prindërve, personelit tjetër shkollor),

- Hartimi i politikave shkollore në përputhje me ato kombëtare,
- Monitorimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm,
- Zbatimi në praktikë i të dhënave të monitorimit dhe vlerësimit, duke i inkorporuar në plane dhe politika shkollore si dhe në aktivitete të ardhshme.

SUPOZIMET KRITIKE

- Vërtetimi nëse janë apo jo adekuate për nga përshtatshmëria, qartësia, cilësia, sasia informacionet, - të përfshira në trajnimin e punonjësve të arsimit
- Mungesë e fondeve të dedikuara për trajnime
- Mundësia për të vjelë kontribute vullnetare për trajnimin e mësimdhënësve si dhe për të siguruar ekspertë, që do të angazhoheshin, po edhe mjete materiale e financiare.

4.4. Përkujdesje cilësore dhe e vazhdueshme për shëndetin e nxënësve

Përkujdesja cilësore dhe e vazhdueshme për shëndetin e nxënësve, kërkon realizimin e të gjithë objektivave të tjerë strategjikë. Kjo, sepse përkujdesja e tillë për shëndetin shihet si produkt i natyrshëm i realizimit të të gjithë objektivave të tjerë strategjikë. Në këtë kontekst, duhet thënë se vetëm realizimi i këtij objektiv strategjik i jep kuptimin e plotë realizimit të objektivave të tjerë strategjikë. Sidoqoftë, realizimi i këtij objektiv strategjik ngërthen në vetvete aktivitete konkrete, me anë të të cilave realizohet.

TREGUESIT

- Deri në vitin 2018 shkollat të ofrojnë shërbime ose shërbime referuese për të gjitha problemet shëndetësore
- Deri në vitin 2018 të gjitha shkollat të kenë një kurrikul dhe materiale edukative shëndetësore të mjaftueshme për t'i plotësuar nevojat e përfituesve të tyre
